

FAKULTETI I ARKITEKTURËS
PROGRAMI STUDIMOR
MSc NË ARKITEKTURË – ME SPECIALIZIME

Viti I

Semestri I			Orë / Javë		
Nr.	O/Z	Lënda	L	U*	ECTS
VII-1	O	Projektimi 7 – Fermat Vertikale	2	2	6
VII-2	O	Projektimi 8 – Objektet Edukative - Arsimore	2	2	6
VII-3	O	Mbrojtja e Trashëgimisë Arkitekturale	2	1	4
VII-4	O	Planifikimi i Qëndrueshëm Urban 1	2	1	4
VII-5	O	Metodologjia e Hulumtimit në Arkitekturë	2	1	4
VII-6	Z-Q	Matematika Financiare dhe Statistika	2	0	3
VII-7	Z-Q	Legjislacioni dhe Menaxhimi në Ndërtim dhe Urbanizëm	2	0	3
VII-8	Z-P	Arkitektura e Brendshme	2	0	3
VII-9	Z-P	Barrierat Arkitektonike	2	0	3
VII-10	Z-T	Arkitektura si Shprehje dhe Interpretim Politik	2	0	3
VII-11	Z-T	Diskurset e Arkitekturës	2	0	3
VII-12	Z-U	Teoria dhe Historia e Urbanizmit	2	0	3
VII-13	Z-U	Planifikimi i Bazuar në Komunitet	2	0	3
VII-14	Z-A	Industria Kreative	2	0	3
VII-15	Z-A	Arkitektura dhe narracioni ne fotografi dhe film	2	0	3
					30

Semestri II			Orë / Javë		
Nr.	O/Z	Lënda	L	U*	ECTS
VIII-1	O	Projektimi 9 – Objektet e Sportit dhe Rekreimit	2	2	6
VIII-2	O	Planifikimi i Qëndrueshëm Urban 2	2	1	4
VIII-3	O	Teoria dhe Praktika e Restaurimit	2	1	4
VIII-4	O	Mbështjellësi i Objektit dhe Fasada	2	1	4
VIII-5	O	BIM	2	1	4
VIII-6	Z-P	Projektim STUDIO - Objektet Shëndetësore	2	3	8
VIII-7	Z-P	Projektim STUDIO - Qendrat për Hulumtim dhe Labor.	2	3	8
VIII-8	Z-P	Projektim STUDIO - Strategjitë e Projektimit	2	3	8
					30

Viti II

Semestri I –SPECIALIZIMI ARK. E PËRGJITHSHME / QËNDRUESHME [Q]			Orë / Javë		
Nr.	O/Z	Lënda	L	U*	ECTS
IX-1-Q	O	STUDIO – Arkitektura e Qëndrueshme	2	2	6
IX-2-Q	O	STUDIO – Trajtimi Preventiv i Ndërtesave	2	2	6
IX-3-Q	O	Laboratori i Dizajnit Kompjuterik	2	2	6
IX-4-Q	O	Superstrukturat Organike në Projektim	2	1	4
IX-5-Q	O	Ndikimi i Ndërtesave në Mjedis	2	1	4
IX-6-Q	Z-A	Aspekti Vizual i Performancës së Ndërtesave	2	1	4
IX-7-Q	Z-P	Projektimi i Integruar – Objektet e Kulturës	2	1	4

IX-8-Q	Z-T	Trashëgimia Moderne	2	1	4
IX-9-Q	Z-U	Qëndrueshmëria Urbane	2	1	4
					30

Semestri I - SPECIALIZIMI PROJEKTIM [P]			Orë / Javë		
Nr.	O/Z	Lënda	L	U*	ECTS
IX-1-P	O	Projektim – Kultura	2	2	6
IX-2-P	O	Projektim – Termialet Multimodale	2	2	6
IX-3-P	O	Projektim – MultiMedia	2	2	6
IX-4-P	O	Projektim – Objektet Polifunkionale	2	1	4
IX-5-P	O	Projektim – Superstrukturat Rezidenciale	2	1	4
IX-6-P	Z-A	Interpretimi Digjital i Funksioneve Projektuese	2	1	4
IX-7-P	Z-U	Sfera Publike dhe Konteksti Urban	2	1	4
IX-8-P	Z-T	Eklektika Ndërdisciplinare në Projektim	2	1	4
IX-9-P	Z-Q	Superstrukturat Organike në Projektim	2	1	4
					30

Semestri I-SPECIALIZIMI URBANIZËM DHE PLANIFIKIM HAPËSINOR [U]			Orë / Javë		
Nr.	O/Z	Lënda	L	U*	ECTS
IX-1-U	O	Planifikim Strategjik Hapësinor – Studio	2	2	6
IX-2-U	O	Dizajn Urban – Studio	2	2	6
IX-3-U	O	Planifikimi i Zhvillimit rural dhe i Turizmit - Studio	2	2	6
IX-4-U	O	Planifikimi i Peizazhit	2	1	4
IX-5-U	O	Metodologjia e Hulumtimit Urban	2	1	4
IX-6-U	Z-A	GIS në planifikim Hapësinor	2	1	4
IX-7-U	Z-P	Studimet e Banimit dhe Zhvillimi Urban	2	1	4
IX-8-U	Z-T	Regjenerimi Urban	2	1	4
IX-9-U	Z-Q	Mobiliteti i Qëndrueshëm Urban	2	1	4
					30

Semestri I - SPECIALIZIMI TRASHËGIMI KULTURORE [T]			Orë / Javë		
Nr.	O/Z	Lënda	L	U*	ECTS
IX-1-T	O	Trashëgimia Kulturore e Kosovës	2	1	4
IX-2-T	O	Antropologjia e Arkitekturës: Kujtesa, Identiteti	2	1	4
IX-3-T	O	Konservimi urban	2	2	6
IX-4-T	O	STUDIO: Ripërdorimi Adaptiv	2	2	6
IX-5-T	O	STUDIO: Trashëgimia Moderne	2	2	6
IX-6-T	Z-A	Digjitalizimi i Trashëgimisë kulturore	2	1	4
IX-7-T	Z-P	Projektimi në Kontekst Kulturor	2	1	4
IX-8-T	Z-U	Planifikimi dhe Turizmi Kulturor	2	1	4
IX-9-T	Z-T	Mbrojta Preventive	2	1	4
					30

Semestri I – SPECIALIZIMI ARKITEKTURA DHE TEKNOLOGJIA [A]			Orë / Javë		
Nr.	O/Z	Lënda	L	U*	ECTS
IX-1-A	O	Laboratori i Dizajnit Kompjuterik	2	2	6
IX-2-A	O	Projektimi Ndërdisciplinar	2	2	6
IX-3-A	O	Zhvillimi i Dizajnit Parametrik në Arkitekturë	2	2	6
IX-4-A	O	Arkitektura e Qëndrueshme dhe Softuerët	2	1	4
IX-5-A	O	Softuerët dhe Web-mobil Aplikacionet	2	1	4
IX-6-A	Z-U	Qytetet e Zgjuara	2	1	4

IX-7-A	Z-P	Projektimi Kinetik Interaktiv	2	1	4
IX-8-A	Z-T	Interpolimi në Arkitekturë	2	1	4
IX-9-A	Z-Q	Hapësira dhe jeta e përditshme	2	1	4
					30

Semestri II			Orë / Javë		
Nr.	O/Z	Lënda	L	U	ECTS
1	O	Punim diplome (MSc)***	/	/	30
					30

*** Studenti merr diplomën MScA me 120 ECTS kredi

Vërejtje:

- (U*) janë ushtrime praktike apo laboratorike të cilat organizohen në grupe sipas Statutit dhe Rregulloreve në fuqi të UP-s (ref: Rregullore 2/486 të datës 11/09/2019, Neni 16 – pika 2, tabela Nr.7 dhe Neni 17 – pika 2, tabela Nr.10)

Përshkrimet e shkurta të lëndëve në programin e studimeve MScA

Titulli i lëndës:	PROJEKTIM 7 – FERMAT VERTIKALE
Mesimdhënesi:	Prof.Ass.Dr. Arta Xhambazi
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	6
Përshkrimi i lëndës:	Kursi Projektim 7: Fermat Vertikale diskuton dhe studion temën e projektimit të Bujqësisë - Fermat Vertikale. Kursi zhvillohet një herë në javë dhe është kurs i integruar me pjesëmarrje interaktive të studentëve. Roli kryesor i kursit është të studiojë dhe të hulumtojë tipologjinë e komplekseve agroindustriale – struktura multifunksionale bashkëkohore, me theks në tipologjinë: Fermave Vertikale, parqet bujqësore, komplekset blegtoje, fermat urbane, kopshtet vertikale, kultivimin e bimësisë, kurse tipologjinë e strukturave multifunksionale do të caktohen për çdo vit akademik sipas trendeve aktuale në bashkëpunim me studentët dhe referencat ndërkombëtare akademike.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kursit është të iniciojë, të përdorë parimet themelore teorike dhe praktike arkitekturore të projektimit, duke përfshirë ndërlidhjen simbiotike të avancimit të teknologjisë dhe projektimit arkitektonik. Objektivat kryesore të kursit janë subjekt i qasjeve të ndryshme ndërdisiplinore për të studiuar dhe kuptuar ndërlidhjen në mes projektimit arkitektonik, parqeve bujqësore, komplekseve blegtoje, agrikultures, kopshtet vertikale, kultivimin e bimësisë, prodhimeve vendore, zhvillimit urban, mirëqenjes publike.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të kursit, studentët duhet të kenë kuptuar dhe zotëruar parimet themelore projektuese të komplekseve multifunksionale - Fermat Vertikale: <ul style="list-style-type: none"> - Studentët kanë zhvilluar aftësitë dhe teknikat në projektim; - Studentët kanë zhvilluar aftësitë e nevojshme për projektim e komplekseve multifunksionale me fokus në Fermat Vertikale; - Studentët kanë zhvilluar aftësi dhe teknika për të përshkruar, analizuar dhe artikuluar procesin e projektimit ndërdisiplinor.
Rëndësia dhe Aktualiteti i Lëndës	Kursi, Projektim 7, Fermat Vertikale, promovon dhe inicon kuptuarjen e njohurive themelore, dhe të avancuara të projektimit arkitektonik. Tematika e shtjelluar në kurs korespondon, dhe aktualisht është në vijë me trendet bashkëkohore të mësimdhënjes në universitetet europiane dhe më gjërë. Studentët janë të pajisur me literaturën primare në gjuhën Shqipe falas, nga mësimdhënësi i kursit.
Metodat e mësimdhënies:	Mësimdhënia ka karakterin e diskutimeve interaktive, duke angazhuar në diskutim të gjithë studentët. Gjithashtu, kursi synon që studentët të marrë pjesë në punë në grup, dhe individuale, të cilët do të marrin detyra konkrete në formën e projekteve ideore arkitektonike. Ligjëratat, dhe ushtrimet gjatë mësimin në klasë përdorin mjete dhe teknika të ndryshme vizuale, kurse gjatë punës me studentë në konsultimet individuale promovohet dhe vlerësohet puna e pavarur në klasë, si dhe angazhimi dhe detyrat e shtëpisë.

Metodat e vlerësimit:	Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë për kursin: <ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja e studentit në ligjerata dhe ushtrime, aktiviteti .. 10% - Vlerësimi obligativ intermediar – Fazat 10% - Portfolio e punimeve grafike, detyrave, seminareve, të vlerësuar me notë - pozitive gjatë semestrit, janë kusht për të marrur ECTS – si dhe janë kusht - për t’iu nënshtruar provimit përfundimtar 50% - Provimi përfundimtar, Test me shkrim. 30%
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Bujar Bajçinovci, Sustainable Architectural Design – principles, in the Albanian Language, 4 (3), JOSHA, 2017. DOI: 10.17160/josha.4.3.306 2. Bujar Bajçinovci, The Vertical Farm, Architectural Design – principles, in the Albanian Language, 4 (5), JOSHA, 2017. DOI: 10.17160/josha.4.5.354 3. Bujar Bajçinovci, The Vertical Farm – Part 2, Architectural Design principles, in the Albanian Language, 5 (6), JOSHA, 2018. DOI: 10.17160/josha.5.6.450
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Dickson Despommier, The Vertical Farm: Feeding the World in the 21st Century. Picador, 2011. New York, USA.

Titulli i lëndës:	PROJEKTIMI 8 - OBJEKTET EDUKATIVE - ARSIMORE
Mesimdhënesi:	Prof.Asoc.Dr. Vlora Navakazi
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	6
Përshkrimi i lëndës:	Kursi përbëhet nga pjesë kryesore tematike, objektet edukativo-arsimore. Vështrimi historik i mendimeve edukative dhe zhvillimi arkitektonik i ndërtesave shkollore, aspekti i planifikimit urb-arkitektonik dhe ambiantal i planifikimit të ndërtesave shkollore, përmbajtjet hapësirore dhe grupet funksionale organizative të shkollës; analiza e tipeve si dhe aspektet e reja të ndërtesave shkollore.
Qëllimet e lëndës:	Zhvillimi i kompetencave të përgjithshme dhe specifike-njohuritë dhe aftësitë. Detyra semestrale është shtylla kryesore e dizajnit sepse lidh dizajnin arkitektonik me kushtet urbanistike dhe kërkesat teknike për ndërtimin e ndërtesave shkollore. Përmes ligjeratave dhe ushtrimeve, nxënësi hyn në metodologjinë e dizajnit të grupeve hapësiror-funksionale të ndërtesës së shkollës e zhvilluar përmes kontekstit, formës, funksionit, teknologjisë dhe materializimit.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Me përfundimin e këtij kursi studenti do të ketë mundësi të: <ul style="list-style-type: none"> - Integroj njohuritë nga disa lëndë të mëparshme profesionale-projektuese, - Zotëroj bazat e projektimit konceptual dhe urban-arkitektonik; - Zbatoj metodologjitë e projektimit arkitektonik; - Zhvilloj qasje kreative individuale për zgjidhjen e problemeve; - Aplikoj analizën e problemeve;

	- Hulumtoj dhe shfrytëzoj materiale dhe teknologji tradicionale dhe bashkëkohore;
Metodat e mësimdhënies:	Ligjerata, mënyra multimediale e prezentimit, komentimi analitik dhe krahasimi përmes të mjeteve të konkretizimit si projektori, llaptopi, tabela; ushtrimet e organizuara me punë në grupe (2 deri 3 studentë); vizita në teren, detyra individuale nën mbikëqyrje.
Metodat e vlerësimit:	Me dorëzimin dhe vlerësimin pozitiv të punimit individual/grupor, studenti fiton të drejtën e nënshkrimit. Kriteret e vlerësimit dhe kalueshmërisë në : Prezenca në ligjerata dhe aktiviteti në ushtrime (10%), eseu (15%), Kolokiumi (15%); projekti Individual/grupor (2-3 studentë) (55%); Provimi përfundimtar (5%).
Literatura primare:	1. Auf-Franić, H., Osnovne škole, Zagreb, Golden marketing – Tehnička knjiga; 2004. 2. Bajbutović, Z., Arhitektura školske zgrade, Sarajevo, „Svjetlost“ OOUR Zavod za udžbenike i nastavna sredstva; 1983. 3. Baylon, M., Školske zgrade, Beograd, Građevinska knjiga; 1972. 4. Dudek, M., Architecture of Schools: The New learning environments, Oxford, Architectural Press; 2000. 5. Përmbledhje e ligjeratave, “Objektet edukativo-arsimore”, Prof,Asss.Dr. Vlora Navakazi
Literatura shtesë:	6. Budde, F. & Theil, H. W., Schulen – Handbuch Für Die Planung Und Durchführung Von Schulbauten, München, Verlag Georg D. W. Callwey; 1969. Ford, A. Designing the Sustainable School, The Images Publishing Group pty LTB, Australia, 2007

Titulli i lëndës:	MBROJTJA E TRASHËGIMISË ARKITEKTURALE
Mesimdhënesi:	Prof.Ass.Dr. Florina Jerliu
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	Lënda është konceptuar që të mundësojë studentët të zhvillojnë të kuptuarit e nocioneve dhe koncepteve të lidhura me trashëgimisë arkitekturale, si dhe të rëndësisë dhe parimeve të mbrojtjes së saj në kontekstin historik dhe gjeografik. Lënda ofron pasqyrë të përgjithshme të çështjeve që lidhen me konceptimin e mbrojtjes, kategoritë dhe dokumentimin e trashëgimisë së ndërtuar, bashkë me parimet, metodat dhe teknikat e mbrojtjes. Për shkak të nevojës gjithnjë e më të madhe për ndëryrje në mjedisin e ndërtuar, dokumentimi shkencor i trashëgimisë arkitekturale (përnjohja, hulumitim, rievimi) do të mësohen në këtë lëndë si segment i punës praktike që e aftëson studentin për punën e ardhshme në definimin e nivelit të intervenimit konservues-restaurues, prezentimin optimal, si dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të trashëgimisë arkitekturale.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kursit është që studentët të njihen me konceptet dhe debatet akademike në fushën e trashëgimisë kulturore në përgjithësi dhe të

	trashëgimisë arkitekturale e peizazheve urbane në mënyrë më specifike; të krijojnë ndjeshmërinë në identifikimin dhe absorbimin e e të dhënave dhe analizës “in situ” të monumenteve, si dhe në rilevim dhe hartim të dokumentacionit grafik, pamor dhe përshkrimor të trashëgimisë arkitekturale.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none"> – zhvillojnë ndjeshmërinë për aplikim të parimeve të mbrojtjes në ndërtesat dhe mjediset e trashëgimisë së ndërtuar – identifikojë dhe referencojë dokumentet doktrinare ndërkombëtare të trashëgimisë kulturore (konventat dhe kartat ndërkombëtare të UNESCO, ICOMOS, KE, etj) – aftësohet për punë hulumtuese dhe praktikë të rilevimit dhe dokumentimit, nën mbikqirjen e përbashkët të mësimeve të kursit dhe institucioneve të trashëgimisë kulturore të Kosovës;
Metodat e mësimdhënies:	Ligjerata tematike, diskutime, vizita studimore, punës praktike në terren (përnjohja, rilevimi) , detyra semestrale (hartimi i dokumentacionit teknik të gjendjes ekzistuese me analiza të devastimit dhe faza të ndërtimit).Kopja e dokumentacionit teknik i vëhet në dispozicion institucioneve bashkëpunuese të trashëgimisë kulturore të Kosovës.
Metodat e vlerësimit:	Vijueshmëria e studentit dhe angazhimi aktiv në klasë 10%, Detyrat semestrale 50%, Vlerësimi nga testet 20% ose Provimi final 40%
Literatura primare:	F.Jerliu (2016) Mbrojtja e Trashëgimisë Ndërtimore. Historia, konceptet, definicionet, metodat dhe teknikat e mbrojtjes. Libri Shkollor, Prishtinë J. Jokilehto (1999). A History of Architectural Conservation, Butterworth-Heinemann, UK R. Thornes, J. Bold. Eds. (1998). Documenting the Cultural Heritage, Getty Information Institute. ICOMOS (2004). International Charters. Conservation and Restoration, 2nd edition
Literatura shtesë:	Miles Glendinning (2013). The Conservation Movement: A History of Architectural Preservation. Antiquity to modernity, Routledge Bernard M. Feilden (1982). Conservation of Historic Buildings. Third edition. Architectural Press, Oxford E. Riza (2002) Teoria dhe praktika e restaurimit të monumenteve të arkitekturës. Instituti I Monumenteve të Kulturës, Tiranë, A. Meksi (2004) Restaurimi i monumenteve të arkitekturës, Uegen, Tiranë
Titulli i lëndës:	PLANIFIKIMI I QENDRUESHEM URBAN 1
Mesimdhënesi:	Prof.Ass.Dr. Dukagjin Hasimja
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	Lënda përbehet prej dy modujve: M.1:Teoria e planifikimit, roli i planifikimit dhe çështjet etike të planifikimit

	<p>Qëllimi i këtij moduli është kuptimi i rolit shoqëror të planifikimit. Kuptimi i teorive bashkëkohore të planifikimit, procedurave të planifikimit dhe çështjeve etike që e shoqërojnë planifikimin. Moduli përmban teoritë klasike të planifikimit dhe ato bashkëkohore. Përqendrimi do të jetë në detyrat, procesin dhe rezultatet e planifikimit.</p> <p>M.2:Zhvillimi i qëndrueshëm urban</p> <p>Qëllimi i këtij moduli është kuptimi dhe vlerësimi i trajtave të shumëfishta të transformimit urban. Në veçanti do të trajtohen pasojat sociale në lidhje me sjelljet, mirëqenien, shpërndarjen, si dhe pasojat mjedisore dhe ekonomike të transformimeve të tilla.</p>
Qëllimet e lëndës:	Studentet duhet të njohin, kuptimin dhe definimin e qytetit, planifikimin e qëndrueshëm urban, teoritë dhe metodat themelore në planifikimin urban, kontekstin ligjor dhe çështjet etike të planifikimit
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Njohja me teoritë dhe metodat e planifikimit urban.</p> <p>Kuptimi i konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm të qytetit duke përfshirë trashëgiminë kulturore dhe rigjenerimin urban.</p> <p>Kuptimi i qytetit si hapësirë ku zhvillohen e funksionet themelore të jetës njerëzore sociale dhe ekonomike dhe të përfitojnë njohuri mbi strukturat qeverisëse, menaxhimin urban dhe procesin e vendim marrjes.</p>
Metodat e mësimdhënies:	Ligjeratë dhe diskutimi në fund të cdo moduli, Projekti hulumtues - punë grupore dhe seminari hulumtues - punë individuale
Metodat e vlerësimit:	<p>Projekti hulumtues dhe Seminari I 25%</p> <p>Seminari II 25%</p> <p>Provimi final 30%</p> <p>Vijimi i rregullt 20%</p>
Literatura primare:	<p>Richard T. Le Gates and Frederic Stout: The City Reader, Routledge, Third Edition 2003</p> <ul style="list-style-type: none"> • Stephen M. Wheeler, Timothy Beatley (2014) Sustainable Urban Development Reader Reutledge London NY • Robert Riddell (2004), Sustainable Urban Planning: Tipping the Balance 1st Edition. Blackwell publishing • Peter Calthorpe (2011) Urbanism in the Age of Climate , Island Press London
Literatura shtesë:	1.Forbes Davidson: Strategic Planning Course materials for Kosova Institute for Spatial Planning, IHS Rotterdam, 2003-2006

Titulli i lëndës:	METODOLOGJIA E HULUMTIMIT NË ARKITEKTURË
Mesimdhënesi:	Prof.Dr. Violeta Nushi
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	Lënda Metodologjia e Hulumtimit në Arkitekturë është lëndë themelore profesionale e cila mëton tu mundëson dhe praktikon studentëve hulumtime

	akademike të cilat do të mbështesin punën në fushën e hulumtimit shkencor dhe profesional të arkitekturës. Veçanërisht do të mësohen temat të cilat kanë të bëjë me metodat, teknikat, instrumentet dhe mekanizmat që shërbejnë për gjetjen, analizën, interpretimin dhe rekomandimin e zgjidhjeve për probleme të ndryshme hipotetike në fushën e arkitekturës. Po ashtu do të mësohen format dhe mënyrat e promovimit të rezultateve të hulumtimit akademik.
Qëllimet e lëndës:	Njohja me kornizën teorike të hulumtimit akademik, definimin e problemit, pyetjet e hulumtimit dhe metodat e hulumtimit në punën akademike: <ul style="list-style-type: none"> • Përfitimi i njohurive mbi konceptet bazë të filozofisë së shkencës; • Zhvillimi i aftësive kritike dhe analitike; • Zhvillimi i shkathtësive të argumentimit; • Qartësia në prezantimin dhe komunikimin e dizajnit dhe kërkimit; • Përsosshmëri në shkrim akademik dhe aftësi komunikimi.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të kursit studenti është në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegojë se çfarë është një kornizë teorike; • Krijojë një kornizë teorike që do të mbështesë hulumtimin; • Identifikojë një numër të autorëve dhe krijuesve të cilët shkruajnë rreth ideve kryesore të kornizës teorike; • Hartojë një raport akademik, në të cilin do të përshkruhet cilat janë pyetjet kryesore të hulumtimit të cilave duhet t'i përgjigjet në tezën e hulumtuar si dhe metodat adekuate për t'u përgjigjur; • Shpjegojë vlerat dhe çështjet etike të ndërlidhura me aktivitetin arkitektonik.
Metodat e mësimdhënies:	Seminare dhe ligjërata: <ul style="list-style-type: none"> • duke diskutuar rolin e teorive për praktikave në fushën e arkitekturës; • duke sqaruar mënyrat në të cilat teori janë përkthyer në praktikë në fusha të ndryshme (sidomos në atë teknike, mjedisore dhe arkitektonike); • duke qartësuar rolin dhe rëndësinë e hulumtimit për praktikën e projektimit dhe anasjelltas; • duke promovuar angazhimin aktiv të studentëve në diskutime, simulime, role dhe promovim të hulumtimit.
Metodat e vlerësimit:	Metodat e vlerësimit përbëjnë një kombinim të vlerësimeve formative-gjatë zhvillimit të projektit hulumtues dhe përmbledhëse-prezantimi dhe provimi.
Literatura primare:	1) Leksionet e mësimdhënësës 2) Linda N. Groat, David Wang (2013), Architectural Research Methods), John Wiley & Sons, Inc, Hoboken, New Jersey
Literatura shtesë:	1) Zelenika, R. “Metodologjia i teknologjia israde znanstvenog i strucnog djela”, Rijeka, 1999 2) Fellows, R. F. & Liu, A., “Reseach Method for Construction”, Oxford, 2008.

Titulli i lëndës:	MATEMATIKA FINANCIARE DHE STATISTIKA
Mesimdhënesi:	Prof.Dr. Fevzi Berisha

Statusi i lendes:	Zgjedhore												
Kredite ECTS:	3												
Përshkrimi i lëndës:	<p>Lënda ka të bëjë me përvetësimin e njohurive nga matematika që janë të nevojshme për lehtësimin e fitimit të njohurive nga lëndët tjera dhe zbatimin e njohurive në problemet nga arkitektura. Ekuacionet diferenciale të zakonshme.</p> <p>Ekuacioni diferencial me variola të ndara, ekuacioni homogjen, ekuacioni linear. Njehsimi i interesit të thjeshtë. Njehsimi i interesit të përbërë. Depozitimi periodik anticipativ. Depozitimi periodik dekursiv. Depozita periodike variabile. Rentat periodike anticipative. Renta periodike dekursive. Kthimi i huas. Njehsimi i kësteve kur dihet huaja dhe anuiteti. Njehsimi i kështit të parë kur dihet huaja. Njehsimi i cilitdo kësht me ndihmën e anuitetit. Njehsimi i pjesës së paguar të huas. Përpilimi i planit të amortizimit. Kuptimi, rëndësia, metodat dhe objekti i statistikës. Organizimi i statistikës. Definimi i elementeve të analizës statistikore. Fazat e studimit statistikor. Kuptimi dhe rëndësia e statistikës përshkruese. Mestarja. Dispersioni. Mediana. Korelacioni dhe regresioni.</p>												
Qëllimet e lëndës:	<p>Studenti do të jetë në gjendje që të përdor dhe të kuptojë drejt nocionet e matematikës së lartë, me qëllim që ato njohuri ti ndihmojnë si aparat ndihmës në lëndët në të cilat është i domosdoshëm përdorimi i aparatit matematikor. Të fitojnë njohuri të nevojshme matematikore për lehtësim të fitimit të njohurive të mëvonshme nga arkitektura</p>												
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Përfitojnë njohuri dhe shprehje për zgjidhjen e metodave më efektive në problemet e ndryshme të arkitekturës.</p> <p>Do të jenë në gjendje që njohuritë e fituara nga matematika financiare dhe statistika ti aplikojnë në përvetësimin më të lehtë dhe më të shpejt të përmbajtjeve nga lëndët tjera të parapara me programin e studimeve nga arkitektura.</p>												
Metodat e mësimdhënies:	Frontale dhe individuale me ligjërata dhe ushtrime. Angazhim i studentit gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve për zgjidhjen e detyrave												
Metodat e vlerësimit:	<p>Vlerësimi përfundimtar bazohet në punën e përgjithshme që ka bërë studenti gjatë gjithë semestrit, sipas përqindjes në vazhdim:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Vlerësimi i parë</th> <th>Vlerësimi i dytë</th> <th>Vijimi i rregullt</th> <th>Angazhimi</th> <th>Provimi final</th> <th>Total</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>20%</td> <td>20%</td> <td>5%</td> <td>10%</td> <td>45%</td> <td>100%</td> </tr> </tbody> </table>	Vlerësimi i parë	Vlerësimi i dytë	Vijimi i rregullt	Angazhimi	Provimi final	Total	20%	20%	5%	10%	45%	100%
Vlerësimi i parë	Vlerësimi i dytë	Vijimi i rregullt	Angazhimi	Provimi final	Total								
20%	20%	5%	10%	45%	100%								
Literatura primare:	<p>1. Ajet Ahmeti – Matematika për ekonomistë, Prishtinë 2012.</p> <p>2. Harshbarger/Reynolds- Mathematical applications- for the management, life and social sciences, Boston, New York,</p> <p>3. Alexs Himonas , Alan Howard - Calculus Ideas and applications, USA, 2003.</p>												

Literatura shtesë:	1. N.L.Brah3a: “Bazat e Statistikës”, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2006 2. Robert D.Mason, Douglas A. Lind &William .Marshall: “Statistical Techniques in Business and Economics”, Tenth Edition, McGraw-Hill International Edition, 2000,
---------------------------	--

Titulli i lëndës:	LEGJISLACIONI DHE MENAXHIMI NË NDËRTIM DHE URBANIZËM
Mesimdhënesi:	Prof.Ass.Dr. Mimoza Dugolli
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Kredite ECTS:	3
Përshkrimi i lëndës:	Në këtë modul trajtohen sipas nënndarjeve ligjet dhe aktet nënligjore në fushën e planifikimit Urban dhe te ndertimit si dhe ligje dhe akte të tjera nënligjore të fushave që kanë ndikim të drejtpërdrejtë apo tërthortë në planifikim urban dhe ndertim.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimet e kësaj lende janë që studenti të kuptojë fillimisht parametrat legjislativ qe percaktojnë: vendosjen e kërkesave minimale për mbrojtjen e shëndetit publik, parametrat e sigurisë dhe mirëqenies së përgjithshme përmes rezistencës së nevojshme të strukturës së hapësirave të emergjencës, ekuilibrit dhe stabilitetit, sanitarisë, menaxhimit të mbeturinave ndërtimore, ndriçimit adekuat dhe ventilimit, masave për efijencë dhe kursim të energjisë, dhe sigurisë së jetës dhe pronës nga zjarri dhe rreziqeve tjera që i atribuohen mjedisit ndërtimor si dhe t’i krijoj siguri zjarrfikësve dhe përgjegjësve tjerë në raste të emergjencave.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit te plote te këtij kursi studentet do te jene ne gjendje të bëjnë interpretimin e ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi që ndërlidhen me zhvillimin e aktiviteteve ndërtimore dhe urbanistike, të drejtpërdrejta dhe tërthorta. Të kuptojnë ato dhe të përdorin për realizimin e aktiviteteve të tyre, si arkitekthe të rinj.
Rëndësia dhe Aktualiteti i Lëndës	Rëndësia e kësaj lënde qëndron në faktin se përmes legjislacionit përcaktohen kërkesat kryesore për percaktimin e zonave për ndërtim, dizajnimin, ndërtimin dhe përdorimin e materialeve ndërtimore, mbikëqyrjen profesionale dhe procedurat për lejet e ndërtimit, lejet për përdorimin dhe inspektimin ndërtimor. Gjithashtu rregullon dizajnimin dhe kushtet e ndërtimit përkitazi me sigurinë publike dhe mbrojtjen e mjedisit në Kosovë .
Metodat e mësimdhënies:	Mësimi do e realizohet përmes ligjëratave, ushtrimeve dhe detyrave ne grupe
Metodat e vlerësimit:	Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 60%. Vijueshmëria e studentit 10%; Detyrat individuale të kryera në klasë 15%; Detyrat individuale të kryera në shtëpi 15%; Vlerësimi nga testet 60%; Provimi final 100%.

Literatura primare:	Ligjëratat e përgatitura nga profesori i lëndës; Legjislacioni ne fuqi i ndërlidhur me fushën e ndërtimit dhe urbanizmit, P.S.Gahlot, B.M.Dhir “Engineering construction planning & management” 2nd edition Barbara J. Jacskon “Construction management Jump start”, 2nd edition,
Literatura shtesë:	Ligjet e tjera te ndërlidhura me fushën e ndërtimit dhe urbanizmit, S. C. Basu Roy “Modern Concept of Total Quality Control and Management for Construction”; Arvind K Sagar Gaurav K Sagar “Construction Technology and Management”; M.K.Gupta “Practical Handbook on Building Construction”

Titulli i lëndës:	ARKITEKTURË E BRENDSHME
Mesimdhënesi:	Prof.Ass.Dr. Arta Xhambazi
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Kredite ECTS:	3
Përshkrimi i lëndës:	Kursi bën përmbledhjen e njohurive teorike të nxëna në vitet paraprake të studimeve të arkitekturës dhe i shtjellon ato nga këndvështrimi i projektimit të hapësirave të brendshme. Përmes shpjegimit të koncepteve esenciale në mënyre logjike dhe të ndjeshme, kursi trajton procesin e projektimit të hapësirave të brendshme që nga kontakti parë me klientin, deri te prezantimi i projektit dhe përtej tij. Konceptualizimi i idesë trajtohet duke elaboruar konceptin e lëvizjes, tredimensionalitetit, konstruksionit, materialit, ngjyrës dhe ndriçimit.
Qëllimet e lëndës:	Trajtimi i historisë dhe teorisë bashkëkohore të Arkitekturës nga këndvështrimi i arkitekturës së brendshme. Shpjegimi i procesit të projektimit të hapësirave të brendshme që nga përpilimi i programit projektues e deri te prezentimi vizual i projektit. Shqyrtimi i rëndësisë së prezantimit të projektit në fazat e ndryshme të projektit. Prezantimi i mundësive të zhvillimit të mëtutjeshëm, përmes pamjeve të veprave të krijuesve të mirënjohur, duke perdour fotografinë si mjet për të shpjegur dhe për tu inspiruar.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Në fund të kursit studenti : <ul style="list-style-type: none"> – Shqyrton dhe analizon komponentët arkitekturale në vepra të tjera të arkitekturës së brendshme si parakusht për nisjen e veprimtarisë vetanake; – Njeh stilet dhe trendet bashkëkohore të projektimit të hapësirave të brendshme – Kupton dhe realizon përpilimin e programit projektues – Aftësohet për realizimin e projekteve të enterierit
Metodat e mësimdhënies:	Ligjerata, analiza të projekteve si dhe temave që ndërlidhen me ligjëratat në mënyrë interaktive me studentë.

	Detyra semestrare realizohet me mbikqyrje gjatë ushtrimeve, si dhe punë individuale në shtëpi.
Metodat e vlerësimit:	Vijimi i rregullt i ligjeratave dhe ushtrimeve është i obligueshëm. Marrja e kredive bëhet me verifikimin e prezencës dhe aktivitetit në ligjerata dhe ushtrime, me projektin semestral të vlerësuar pozitivisht si dhe provimin e vlerësuar pozitivisht.
Literatura primare:	Designing Interiors, 2nd ed., Rosemary Kilmer& Otie Kilmer, John Wiley & Sons, 2014 Interior Design: Conceptual Basis, Anthony Sully, Springer International Publishing, 2015 The Fundamentals of Interior Architecture, John Coles/Naomi House, AVA Publishing SA, 2007
Literatura shtesë:	The Fundamentals of Interior Design, Simon Dodsworth, AVA Publishing SA, 2009 Drawing for Interior Design, 2nd ed, Drew Plunkett, Laurence King Publishing Ltd, 2014 Lighting for Interior Design, Malcolm Innes, Laurence King Publishing, 2014

Titulli i lëndës:	BARRIERAT ARKITEKTONIKE
Mesimdhënesi:	Dr.sc. Rozafa Basha
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Kredite ECTS:	3
Përshkrimi i lëndës:	Në një shoqëri në rritje dhe plakje, ku nevoja për zgjidhje të qëndrueshme (si ato sociale dhe mjedisore) është kritike, përfaqëson projektuese gjithëpërfshirëse (sikurse Dizajni Universal) janë pranuar globalisht si një mjet për të përmbushur nevojat ekzistuese dhe të ardhshme të individëve dhe grupeve. <i>Dizajni Universal</i> është një mënyrë mendimi, që kërkon nga projektuesi të marrë në konsideratë pasojat e dizajnit dhe t'i vendosë nevojat e të gjithë njerëzve në zemër të procesit. Pjesa teorike dhe praktike e modulit do t'i njoftojë studentët me nocionet e barrierave arkitektonike dhe qasjen në mjedisin e ndërtuar. Kursi gjithashtu do të prezantojë përfaqësimin e dizajnit gjithëpërfshirës për krijimin e mjedisit pa barriera. Do të diskutohet edhe filozofia e Dizajnit Universal bashkë me çështjet ndërlidhëse sociale, ekonomike, legjislativë, etj. si dhe do të prezantohen zhvillimet më të fundit në këto fusha.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kursit është që t'i njoftojë studentët me nocionet e barrierave arkitektonike, qasjen në mjedisin e ndërtuar dhe përfaqësimin e dizajnit gjithëpërfshirës për krijimin e mjedisit të ndërtuar pa barriera.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> • Të njoh dhe të ketë kuptim praktik të Dizajnit Universal, siç zbatohet në dizajnin arkitektonik; • Të kuptojë kërkesat ligjore për mjedisin e ndërtuar pa pengesa; • Të kuptojë përfitimet sociale të mjedisit të ndërtuar pa pengesa; • Të demonstrojnë vetëdije të lartë në lidhje me zhvillimin dhe zbatimin e koncepteve të reja kërkimore dhe përparimet në terren;

	<ul style="list-style-type: none"> Të zbatojë, demonstrojë dhe përkthejë përjasjen e metodave të Dizajnit Universal në projekte konkrete arkitektonike.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata, punëtori të shkurtëra projektuese, vizita në terren dhe diskutime seminarike. Disa moduj të këtij kursi do të përfshijnë diskutimet interaktive dhe metodat e mësimin problemor.
Metodat e vlerësimit:	Pjesëmarrja në ligjërata dhe ushtrime - 5%; Seminar - 20%; Kollokuium 1 - 15%; Kollokuium 2 - 15%; Dorëzimi dhe prezantimi i projektit grafik 45%; Studentët që nuk i kalojnë kollokuiumet duhet t'i nënshtrohen provimit.
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> Presier W., Smith K., Universal Design Handbook, Mc Graw Hill, 2010 Lebbon C., Clarkson J., Coleman R. & Keates S., Inclusive Design: Design for the Whole Population, Springer Verlag, 2003 Keates S. L., Clarkson J., Countering Design Exclusion: An Introduction to Inclusive Design, Springer Verlag, 2004
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> Imrie R., Accessible Housing: Quality, Disability and Design, Routledge, 2005 Steinfeld E., Maisel J., Universal Design: Creating Inclusive Enviroments, Wiley, 2012

Titulli i lëndës:	ARKITEKTURA SI SHPREHJE DHE INTERPRETIM POLITIK
Mesimdhënesi:	Prof.Ass.Dr. Teuta Jashari Kajtazi
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Kredite ECTS:	3
Përshkrimi i lëndës:	Perderisa ekziston marrëdhënia strukturore në mes të anës sociale dhe asaj politike në shoqëri, arkitektura është ajo e cila thekson fuqinë e kesaj marrëdhënie, me saktësi me arkitekturën monumentale e cila formësohet nga fuqitë e caktuara politike. Në raport me këtë, lenda tregon mundësitë e interpretimit të politikave të ndryshme sociale, shoqërive dhe periudhave të caktuara nëpërmes arkitektures.
Qëllimet e lëndës:	Shprehja e identitetit të një shoqërie apo kombi, përfaqësimi jashtë kufinjve të vendit, ruajtja e identitetit, të gjitha këto nëpërmes shprehjes arkitekturore.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Njohja me konceptin e identitetit arkitekturor, shprehjen e identitetit kombëtar nëpërmes arkitektures, interpretimin politik dhe shoqëror nëpërmes përfaqësive diplomatike, si dhe njohja me format e ndryshme të interpretimit dhe reinterpretimit të strukturave të ndërtuara në kohë të caktuara dhe të rëndësishme të vecant për një shoqëri apo komunitet.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata/ Leksione teorike dhe praktike Obligimet semestrale të studentëve janë si në vijim: - Pune grupore (tre pjesëmarrës me se shumti) - Detyra semestrale përfshijnë hulumtim, casje teorike dhe interpretative të shprehjes së politikës nëpërmes arkitektures

Metodat e vlerësimit:	Detyra semestrare_50% Prezentimet semestrare_40% Vijimi i rregullt dhe aktiviteti_10% Totali_100% - Sic shihet me larte, vleresimi ne lende behet nepermes suksesit te arritur ne detyre semestrare dhe prezentimeve te lidhura me detyren, te cilat do te behen tre here gjate semestrit (duke e percjellur keshtu ecurine e punimit)
Literatura primare:	Power and Architecture: The Construction of Capitals and the Politics of Space; <i>Michael Minkenberg</i> , 2014 Behind the national identity; Political and social activity through architecture; Liberal Socialism in Kosovo; <i>Teuta Jashari-Kajtazi</i> , 2016 http://repositum.tuwien.ac.at/obvutwhs/download/pdf/1747161?originalFile_name=true
Literatura shitesë:	The Architecture of Community; <i>Leon Krier</i> , 2009

Titulli i lëndës:	DISKURSET NË ARKITEKTURË
Mesimdhënesi:	Prof.Ass.Dr. Florina Jerliu
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Kredite ECTS:	3
Përshkrimi i lëndës:	Lënda shtjellon temat kryesore të arkitekturës si tektonika, përdorimi dhe vendi, të cilat mbeten qendrore për disiplinën mbi dymijëvjecare të arkitekturës. Zhvillimi i hovshëm sot sjell vijueshëm materiale dhe teknologji të reja, e gjithashtu sfidat mjedisore dhe sociale janë gjithnjë në rritje. Kjo bën që aktualiteti i të përditshmes të përcaktohet si kohë jetike për të studiuar diskurset në arkitekturë. Lënda informon studentët mbi fenomenet, nocionet dhe diskutimet në disiplinën e arkitekturës në formë të një bisede trilogjike midis teksteve diskursive si tezë (teksti burimor), antitezë (teksti reflektiv) dhe sintezë (teksti filozofik). Tekstet burimore, të cilat janë qendrore për të kuptuar diapazonin e debatit në arkitekturë janë shkruar nga arkitektë dhe kritikë e filozofë të arkitekturës, dhe jo rrallë janë manifestuar si vepra arkitektonike në formë të manifestit arkitektural.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i lëndës është që studentët të mësohen të ambientojnë rolin e tyre kundrejt sfidave dhe mundësive të reja të disiplinës. Duke qenë se debati përqendrohet në mënyrën se si struktura, hapësira, forma, materiali, programi dhe konteksti janë transformuar për të adresuar këto çështje, studentët bëhen pjesë aktive në këtë transformim, duke u mësuar që të zhvillojnë konceptin arkitektonik të gjeneruar nga një pozitë teorike.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> – zhvillojnë dhe përmirësojnë kulturën e debatit dhe aftësinë e njohjes së dialektikës në arkitekturë – krijojnë një kornizë kritike të gjykimit për idenë, konceptet themelore dhe prodhimin arkitektonik në kontekst, rrjedhimisht të bëhen pjesë e diskursit arkitektural;

	<ul style="list-style-type: none"> – zhvillojnë aftësitë për të argumentuar dhe paraqitur në një mënyrë të strukturuar propozimet, idetë dhe projektet e tyre të gjeneruara nga qasja diskursive.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjeratë e avansuar dhe diskutime, detyrë shtëpie grupore dhe individuale.
Metodat e vlerësimit:	Vijueshmëria e studentit dhe angazhimi aktiv në klasë 10%, Detyrat seminarike dhe prezantimet e studentëve 60%, Vlerësimi nga testet 15% ose Provimi final 30%
Literatura primare:	C.G. Crysler (2003). Writing Spaces. Discourses of Architecture, Urbanism, and the Built Environment 1960-2000, Routledge K. Smith (2012). Introducing Architectural Theory: Debating A discipline, Routledge, New York, NY E. Ots, (2010) Decoding Theoryspeak, Routledge, New York, NY Hanno-Walter Kruft (1996) History of Architectural Theory, from Vitruvius to the present, 1 edition, Princeton Architectural Press
Literatura shtesë:	F.Jerliu (2005) Dispencë: Teoria dhe Kriticizmi në Arkitekturë, UP/WUS Hilde Heynen (2000) Architecture and modernity, A Critique, The MIT Press; Revised edition Ch. Jencks , K.Kropf (2006)Theories and manifestoes of contemporary architecture, second edition, Academy Press H. Pai, H. Pae (2002). The Portfolio and the Diagram: Architecture, Discourse, and Modernity in America, MIT Press

Titulli i lëndës:	TEORIA / HISTORIA E URBANIZMIT
Mesimdhënesi:	Dr.Sc. Ilir Gjinolli
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Kredite ECTS:	3
Përshkrimi i lëndës:	<p>Cka është qyteti dhe si lindi ai? Cilat janë funksionet e tij dhe çfarë qëllime përmbush ai? Cilat janë format e zhvillimit dhe rritjes së tij dhe cilat janë shkollat që diktuan dhe kontribuan në idetë e zhvillimit të qytetit?</p> <p>Lëvizjet e popullësisë, hapësira gjinore dhe multiukulturore, proceset e globalizimit dhe ekonomitë e reja formësojnë qytetet tona cdo ditë duke i bërë disa nga qytetet, pika të forta në rrjetin global të komunikimit.</p> <p>Cilat janë lëvizjet aktuale sociale urbane dhe suburbane si dhe cilat janë politikat urbane të cilat do të orientojnë zhvillimin e një qyteti të shëndetshëm dhe gjithpërfshirës në të ardhmen</p>
Qëllimet e lëndës:	Njohja teorike dhe kuptuarja e qyteteve në perspektivën historike, kulturore dhe socio-ekonomike përmes ligjëratave dhe punës hulumtuese dhe kritike.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> • Njohja e historisë së zhvillimit të qyteteve • Njohja me shkollat që zhvilluan teoritë dhe mendime kritike për zhvillimin e qyteteve • Rëndësia dhe njohja e kompleksitetit të qyteteve <p>Përvetësimi i koncepteve themelore</p>

Metodat e mësimdhënies:	<ul style="list-style-type: none"> • Ligjeratë dhe diskutimi në fund të cdo moduli, • Seminari hulumtues – punë individuale
Metodat e vlerësimit:	<ul style="list-style-type: none"> • Seminari hulumtues 50% • Provimi final 40% • Vijimi i rregullt 10%
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1.Key concepts in Urban Studies”, Mark Gottdenier and Leslie Budd, Sage Publication/London 2.“The city reader”, Richard T. LeGates and Frederic Stout 3.“Sociologjia Grada”, Sreten Vujovic 4.“The city in History”, Lewis Mumford 5.“The city cultures reader”, Malcom Miles, Tim Hall and Iain Borden – Routledge/London 5.“The art of city making”, Charles Landry, Earthscan/London 6.“Writings in Urbanism”, edited by Douglas Kelbaugh and Kit Krankel Mccullough 7.“European Cities and Towns 400-2000”, Peter Clark, Oxford/London 8.“Cities and Society”, edited by Nancy Kleniewsky, Blackwell Publishing 9.“Encyclopedia of Urban Studies” edited by Ray Hutchison, Sage Publications 10.“Cities And Cultures”, Malcom Miles, Routledge/ London and New York.
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 11.“Understanding the City” edited by John Eade and Christofer Mele, Blackwell Publications 12.“Imagining Cities”, Sallie Westwood and John Williams, Routledge/ London and New York.

Titulli i lëndës:	PLANIFIKIMI I BAZUAR NË KOMUNITET
Mesimdhënesi:	Prof.Ass.Dr. Dukagjin Hasimja
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Kredite ECTS:	3
Përshkrimi i lëndës:	<p>Planifikimi I suksesshëm sot do të duhej të përfshijë brenda procesit njëzëz dhe organizata të ndryshme profesionale dhe komunitare të cilat do ta pasuronin procesin me njohuri specifike për kontekstin e dhënë, për rregullativat, ligjet dhe çështje të tjera me rëndësi publike. Kjo garantohet me karta ndërkombater në fuqi por edhe me ligjet e planifikimit në vende të ndryshme.</p> <p>Lënda përfshin teori/instrumenta dhe shembuj se si mund të përfshihet dhe mobilizohet komuniteti në proceset e planifikimit dhe zhvillimit të qytetit.</p>
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi I lëndës është to aftësoj studentët për rëndësinë e iniciativat poshtë- lartë që e prodhojnë qytetin dhe ti aftësoj poashtu se si ta zhvillojnë procesin e planifikimit me grupe të ndryshme të interesit në faza të caktuara dhe nivele të caktuara të planifikimit dhe zhvillimit.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Zhvillimi I praktik i studentwve pwr punwn nw komunitete tw ndryshme pwrmes instrumenteve tw ndryshme dhe fryma e aktivizmit dhe mobilizimit urban.

Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata tematike, Ushtrimet: Zhvillim i procesit me komunitet duke përdorur një nga metodologjitë. Prezentimet/diskutimet
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi formativ (zhvillimi i studentit gjatë procesit të semestrit) dhe përmbledhës (puna finale-produkti/projekti/ seminari). Detyra semestrale / Ese/ seminari/prezentimi 60% Testet semestrale (2) 40% (apo provimi) Totali 100%
Literatura primare:	1. Whyte, William – The social Life of Small Urban Spaces, 2. Wates, Nick – The Community Planning Handbook 3. Flanigan, w. 1993. “Contemporary Theories of Urbanism and Community”, pp. 13-44, in <i>Contemporary Urban Sociology</i> 4. Sarkissian, Wendy and Hurford Dianna – <i>Creative Community Planning:</i> 5. Elliot, Brayon – <i>Constructing Community – Lexington books</i> 6. Etingoff, Kimberly – <i>Urban Land Use – Community-based Planning, CRC Press</i>
Literatura shtesë:	1. Knox, Paul-Pinch, Steven, <i>Urban Social Geography, An Introduction</i> , Prentice Hall 2. Whitzman Caroline, <i>The Handbook of Community Safety, Gender AND Violence Prevention: Practical Planning Tool</i> 3. Kageyama, Peter – <i>For the Love of Cities</i> , 4. Landry, Charles - <i>The Creative City: A Toolkit for Urban Innovators and The Art of City Making</i> 5. Gehl, Jan – <i>Cities for People</i> , 6. Gehl Jan – <i>Hoë to study Public Life</i> , 7. PPS – <i>Hoë to turn a place around</i> , Neë York 8. Giesecking, Jack Jen - <i>People, Place and Space Reader</i> , Routledge Press 9. Low SETHA – <i>Spatializing Culture</i> , Routledge Press, 2016 10. Mitchell, Don – <i>The right to the city: Social Justice and the Fight for Public Space</i> , The Guilford Press, New York-London

Titulli i lëndës:	INDUSTRIA KREATIVE
Mesimdhënesi:	Prof.Asoc.Dr. Arta Basha Jakupi
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Kredite ECTS:	3

Përshkrimi I lëndës:	Industritë e reja krijuese po fuqizojnë mënyra të reja të konsumit bashkëpunues, krijimin dhe ripërdorimin e medias. Kjo shpesh mbështetet në bashkëpunime të suksesshme ndërmjet artistëve, projektuesve dhe teknologëve të trajnuar, si dhe reflektimit kritik mbi shpërndarjen, pjesëmarrjen, ndërveprimin dhe audiencën. Ky kurs është i dizajnuar për të përgatitur inxhinierë dhe shkencëtarë për të punuar në këto kontekste. Deri në fund të kursit, studentët do të jenë në gjendje të mendojnë në mënyrë kritike në disa paradigma të teorisë së medias; formulojnë qëllimin e punës së tyre krijuese; artikulojnë marrëdhëniet me artin / praktikën dhe teorinë e dizajnit; dhe të përgjigjet me insightful për rezultatet krijuese. Qëllimi nuk është thjesht të krijojë rezultate kreative të mediave, por edhe të mendojnë në mënyrë kritike rreth prodhimit të tyre.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kursit është që të përqendrohet në fushën e zhvendosur dhe kontestuese të industrive kulturore dhe krijuese; betejat (siç përfaqësohen nga autorët kryesorë) për të artikuloar dhe ri-artikuloar ato në nocionet e kulturës, ekonomisë, teknologjisë dhe individëve. Qëllimi i tij është të mundësojë studentët të zhvillojnë një kuptim të nuancuar të industrive kulturore dhe krijuese, si konceptuale dhe empirike, ashtu edhe në aspektin organizativ, hapësinor dhe historik.
Rezultatet e nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti duhet të: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Mund të numërojë veprat relevante paraprake që kanë të bëjnë me projektet personale ▪ Të jetë në gjendje të reflektojë në mënyrë kritike mbi rolin e medias digjitale në eksplorimin e artit-teknologjisë ▪ Të jetë në gjendje të reflektojë në mënyrë kritike në rezultatet e mediave personale bazuar në marrëdhëniet me punën e mëparshme • Studentët do të bëhen konsumatorë kritik dhe prodhuesit e përvojave të mediave. Ata do të: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të jetë në gjendje të artikulojë qëllimin (të menduarit kritik, qëllimi, provokimi) dhe efekti (reagimi, reflektimi, veprimi) i rezultateve të mediave të reja; ▪ Demonstrojnë aftësinë për të kapur, kompozuar, analizuar, hulumtuar, kritikuar dhe reflektuar mbi rezultatet e medias;
Metodat e të mësuarit:	Ligjërata, punë në terren, analiza e studimit të rasteve, punë seminarike dhe punë studimore. Hulumtimi zhvillohet në grupe tematike, ndërsa projekti është individual ose në grupe.
Metodologjia e vlerësimit:	Projektet kreative: Studentët do të përgatisin projekte krijuese të pavarura dhe bashkëpunuese me kolegët e tyre. Secili prej këtyre projekteve krijuese do të lidhet drejtpërdrejt me temat e prezantuara në modul. Ekspozita dhe prezantimi: Studentët do të shfaqin përfundimin e tyre përfundimtar si një ekspozitë të hapur të veprave krijuese.
Literatura Primare:	Caves, R., 2000. <i>Creative industries: contracts between art and commerce</i> . Cambridge MA: Harvard University Press.

Literatura Shtesë:	<p>Flew, T., 2012. <i>Creative industries</i>. London: Sage.</p> <p>Florida, R., 2012. <i>The rise of the creative class, revisited</i>. New York: Basic.</p> <p>Hesmondhalgh, D., 2013. <i>Cultural industries</i>. 3rd ed. London: Sage.</p> <p>Jenkins, H., 2006. <i>Convergence culture: where old and new media collide</i>. New York: NYU Press.</p> <p>Ross, A., 2009. <i>Nice work if you can get it: life and labor in precarious times</i>. New York: NYU Press.</p> <p>Stokes, D., Wilson, N. and Mador, M., 2010. <i>Entrepreneurship</i>. London: Cengage.</p> <p>Zukin, S. 2010. <i>Naked city: the death and life of authentic urban places</i>. New York: Oxford University Press.</p>
---------------------------	---

Titulli i lëndës:	ARKITEKTURA DHE NARRACIONI NE FOTOGRAFI DHE FILM
Mesimdhënesi:	Prof.Asoc.Dr. Arta Basha Jakupi
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Kredite ECTS:	3
Përshkrimi I lëndës:	Përmes evolucionit të mediave vizuale ne jemi në gjendje të shohim, të dëgjojmë dhe të ndajmë përvojat e banorëve në mbarë botën dhe ti analizojmë ndryshimet në mënyren e jetesës, ndryshimin e qyteteve dhe ndryshimin e sjelljeve tona rreth botës gjithnjë e më urbane në të cilën jetojmë. Pikturat, fotografitë dhe filmat mund të dokumentojnë këto transformime të mjedisit të jetesës dhe gjithashtu të parashikojnë se si mund të jetë në të ardhmen.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kësaj lënde është të hulumtojë dhe të interpretojë marrëdhëniet e arkitekturës me pikturën, fotografinë dhe filmat duke analizuar punën e artistëve dhe regjisorëve, veprimtaria e të cilëve ndërlihet me arkitekturën.
Rezultatet e nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi, studenti do të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Identifikoj rolin dhe marrëdhënien e arkitekturës me pikturat, fotografinë dhe filmat; - Krahasoj mediat vizuale të ndryshme të reprezentimit të arkitekturës, identifikoj avantazhet dhe disavantazhet e përdorimit të pikturës, fotografisë ose filmit për të reprezentuar arkitekturën; - Përshkruaj rolin e evolucionit të mediave vizuale në arkitekturë; - Jep shembuj se si mediat vizuale e reprezentojnë të kaluarën; - Analizon se si mediat vizuale parashikojnë arkitekturën dhe nëse ajo ka ndonjë efekt në jetën reale; - Zhvillojë një perspektivë kritike të përdorimit të arkitekturës dhe mediave vizuale;
Metodat e të mësuarit:	Ligjërata, puna në terren, analiza e studimit të rasteve, detyrat seminarike dhe puna studimore. Hulumtimi zhvillohet në grupe tematike, ndërsa projekti është individual ose në grupe.
Metodologjia e vlerësimit:	Metodologjia e vlerësimit do të bazohet në vlerësimin e punimit hulumtues seminarik, formulimin dhe zhvillimin e argumenteve, ecurinë gjatë gjithë

	semestrit duke përfshirë pjesëmarrjen në klasë, pjesëmarrjen gjatë vizitës së veprave të artit apo gjatë shfaqjes së filmave, përfshirjen në diskutime, punën ekipore, përkushtimin.
Literatura Primare:	BRUNO, G. Public intimacy: Architecture and the visual arts. Cambridge (Massachusetts): MIT, 2007.
Literatura Shtesë:	ALBRECHT, D. Designing dreams: Modern architecture in the movies. London: Thames and Hudson, 1987. BARBER, S. Projected cities: Cinema and urban space. London: Reaktion Books, 2002. COVERT, N. Architecture on screen. Boston: G.K. Hall, 1994. FITZMAURICE, T. & SHIEL, M. Cinema and the city: Film and urban societies in a global context. Oxford: Blackwell Publishers, 2001. Peter Brunette & David Wills . Deconstruction and the Visual Arts: Art, Media, Architecture (Cambridge Studies in New Art History and Criticism) Hardcover – October 29, 1993

Titulli i lëndës:	PROJEKTIMI 9 - OBJEKTET E SPORTIT DHE REKREIMIT
Mesimdhënesi:	Prof.Asoc.Dr. Vlora Navakazi
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	6
Përshkrimi i lëndës:	Kursi shqyrton objektet rekreativo-sportive. Përmbajtja e nocioneve dhe planifikimi i strukturës rrjetore të objekteve edukatës fizike, rekreimit dhe sportit, Objektet e hapura (stadiumet dhe pishinat e hapura) dhe të mbyllura (palestrat dhe pishinat e mbyllura) të sportit si dhe aspektet e formave arkitektonike të tendencave të zhvillimit të objekteve edukatës fizike, rekreimit dhe sportit (EFRS) Njohje me specifikat, karakteristikat, përmbajtjet programore dhe metodat e projektimit Përveq zhvillimit historik, shtrirjes dhe rrjetit të shpërndarjes së këtyre objekteve studentët do të njihen edhe me karakteristikat specifike të zgjidhjeve funksionale dhe kërkesave konstruktive për çdo lloj të tipologjisë se posaqme të objekteve sportive.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kursit është njoftimi i studentëve për projektimin, organizimin hapësinor dhe teknologjinë e ndërtimit të objekteve të përfshirë në këtë lëndë
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Me përfundimin e këtij kursi studenti do të ketë mundësi të: - Zotëroj bazat e projektimit konceptual dhe urban-arkitektonik; - Zbatoj metodologjitë e projektimit arkitektonik; - Zhvilloj qasje kreative individuale për zgjidhjen e problemeve; - Aplikoj analizën e problemeve; - Hulumtoj dhe shfrytëzoj materiale dhe teknologji tradicionale dhe bashkëkohore;
Metodat e mësimdhënies:	Ligjerata, mënyra multimediale e prezentimit, komentimi analitik dhe krahasimi përmes të mjeteve të konkretizimit si projektori, llaptopi, tabela;

	ushtrimet e organizuara me punë në grupe (2 deri 3 studentë); vizita në teren, detyra individuale nën mbikëqyrje.
Metodat e vlerësimit:	Me dorëzimin dhe vlerësimin pozitiv të punimit individual/grupor, studenti fiton të drejtën e nënshkrimit. Kriteret e vlerësimit dhe kalueshmërisë në : Prezenca në ligjerata dhe aktiviteti në ushtrime (10%), eseu (15%), Kolokiumi (15%); projekti Individual/grupor (2-3 studentë) (55%); Provimi përfundimtar (5%).
Literatura primare:	1. Adler, D., METRIC HANDBOOK – Planning and Design Data (second edition), Architectural Press, OXFORD, 2000 2. Baiche, B. Walliman, N., Neufert-Architects' Data (third edition), Oxford, 2000; 3. Rod Sheard, SPORTS ARCHITECTURE:, Spon Press, London&NY, 2001. 4. Ilić, S., Sportski objekti, BEOGRAD, 1998 5. Përmbledhje e ligjeratave, “Objektet e Sportit dhe Rekreimit”, Dr.sc.Vlora Navakazi
Literatura shtesë:	Periodiku: 6. Architectural Review 1244/2000. - OI Australija 7. Baumeister 8/1992. - OI Barcelona 8. l'ARCA 122/998. - SPORTS FACILITIES 9. AW - architektur+wettbewerb 188/2001. - Buildings for sport and leisure

Titulli i lëndës:	PLANIFIKIMI I QENDRUESHEM URBAN 2
Mesimdhënesi:	Prof.Ass.Dr. Dukagjin Hasimja
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	Në studion e planifikimit, bërthama e aktiviteteve mësimore është puna në projekt e studentëve nën mbikëqyrjen e mesimdhënësve. Studentët, në bashkëpunim me mesimdhënësit, do të zgjedhin një qytet në Kosovë si lokacion të zhvillimit të projektit. Puna në projekt zhvillohet në grupe prej 4-6 studentëve e përkrahur nga mesimdhënësit dhe përkrahjet nga ligjerata, udhëheqja e mesimdhënësve dhe punëtoritë e veçanta. Lokacioni i projektit dhe problemet duhet të identifikohen dhe të aprovohen nga mesimdhënësit jo më larg se 2 javë pas fillimit të semestrit Puna në projekt do të zhvillohet përmes tri fazave: <ul style="list-style-type: none"> • definimi i problemeve, • analizat e problemeve dhe • propozimet për planin zhvillimor
Qëllimet e lëndës:	Kandidatët do të jenë aftësuar për pjesëmarrje efektive në procesin e hartimit të një plani zhvillimor urban për tërë qytetin.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Kandidatët kanë zhvilluar aftësitë e tyre dhe teknikat e hulumtimit, komunikimit dhe veprimit në planifikimin urban

	<p>Kandidatët kanë përfitur njohuri dhe aftësi për planifikim në nivelin urban. Pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të marrin pjesë në hartimin e planit zhvillimor urban për tërë qytetin.</p> <p>Kanë zhvilluar aftësitë komunikuese në procesin e planifikimit urban - prezantimi i komunikimit si proces i dizajnit me mjete vizuale, gojore, të shkruara të kombinuara me qëllim të zhvillimit të menduarit komunikativ</p>
Metodat e mësimdhënies:	Puna praktike në projekt e përkrahur me ligjërata dhe diskutime dhe udhëheqja nga mësimdhënësit
Metodat e vlerësimit:	<ul style="list-style-type: none"> • Projekti 70% • Provimi final 30%
Literatura primare:	<p>2. Antonia Layard, Simin Davoudi and Susan Batty: Planning for a sustainable future, SPON Press, First Edition, 2001</p> <p>Stephen M. Wheeler, Timothy Beatley (2014) Sustainable Urban Development Reader Reutledge London NY</p> <p>Robert Riddell (2004), Sustainable Urban Planning: Tipping the Balance 1st Edition. Blackwell publishing</p> <p>Peter Calthorpe (2011) Urbanism in the Age of Climate , Island Press London</p>
Literatura shtesë:	1. Forbes Davidson: Strategic Planning Course materials for Kosova Institute for Spatial Planning, IHS Rotterdam, 2003-2006

Titulli i lëndës:	TEORIA DHE PRAKTIKA E RESTAURIMIT
Mesimdhënesi:	Prof.Ass.Dr. Florina Jerliu
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	<p>Lënda është konceptuar që të mundësojë studentët që të njihen për së afërmi me teorinë dhe qasjet e restaurimit dhe të konservimit urban, si dhe me praktikën e konservimit-restaurimit në botë dhe në Kosovë. Komponenta praktike e lëndës përfshin hartimin e projektit të restaurimit që si rezultat do t'u mundësojë studentëve përcaktimin e drejtë të llojit dhe niveit të ndërhyrjes, prezantimit optimal dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të trashëgimisë së ndërtuar në kushte bashkëkohore. Projekti i restaurimit kërkon si parakusht hartimin e dokumentacionit teknik të gjendjes ekzistuese të lokalitetit/monumentit, prandaj, kjo lëndë si prerekuizit ka kryerjen me sukses të obligimeve të lëndës Mbrotja e Trashëgimisë Arkitekturale.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi i kursit është që studentët të fitojnë njohuritë themelore në leximin e mjedisit kulturor, të aftësohen në valorizim dhe përshkrim të testit të autenticitetit sipas standardeve evropiane dhe praktikave të UNESCOs. Në kuptimin e njësimi teorik me praktikën e restaurimit, kursi synon aftësimin e studentëve në aplikim shkencor dhe të ndjeshëm të parimeve, masave dhe teknikave të restaurimit, të nevojshme për krijimin e kulturës së projektimit arkitektonik për ndërtesa dhe zona historike, në linjë me</p>

	trendet bashkëohore dhe nevojat për shfrytëzimin e qëndrueshëm të trashëgimisë së ndërtuar.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që të:</p> <ul style="list-style-type: none"> – zhvillojë ndjeshmërinë për aplikim të parimeve dhe shkallëve të ndërhyrjes gjatë hartimit të projektit të restaurimit – krijojë qasje të bazuar në propozimet e restaurimit duke harmonizuar nivelet e lejuara të intervenimit me kërkesat e shfrytëzimit të ndërtesës/lokalitetit – nxisë kreativitetin dhe invencionin në rikrijim të qëndrueshëm arkitektonik nëpërmjet “modestisë” së qasjes minimale por domethënëse dhe konceptuale, si kusht për mbrojtje dhe ruajtje të autenticitetit/integritetit dhe rritjes së vlerës së trashëgimisë kulturore
Metodat e mësimdhënies:	Ligjerata tematike, diskutime, punëtori me ligjërues të ftuar, vizita në terren, projekti i restaurimit si detyrë semestrale. Kopja e dokumentacionit të projektit të restaurimit i vëhet në dispozicion Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve të Kosovës.
Metodat e vlerësimit:	Vijueshmëria e studentit dhe angazhimi aktiv në klasë 10%, Detyrat semestrale dhe prezantimet e studentëve 60%, Vlerësimi nga testet 15% ose Provimi final 30%
Literatura primare:	<p>F.Jerliu (2016). Mbrojtja e Trashëgimisë Ndërtimore. Historia, konceptet, definicionet, metodat dhe teknikat e mbrojtjes. Libri Shkollor, Prishtinë</p> <p>F.Jerliu (2017). Trashëgimia Kulturore e Kosovës. Konceptet dhe Kontekstet e Mbrojtjes, Prishtinë</p> <p>Francesco Bandarin, Ron van Oers (2012). The Historic Urban Landscape. Managing Heritage in an Urban Century, First Edition. wiley & Blackwell, UK</p> <p>Erica Avrami, Et.al. Eds (2000). Values and Heritage Conservation. Research Report. The Getty Conservation Institute, Los Angeles</p> <p>Charles Bloszies (2012). Old Buildings New Designs, Princeton Architectural Press</p>
Literatura shtesë:	<p>F.Jerliu/MKRS (2017). Strategjia Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2017-2027</p> <p>Robert Pickard (2002). European cultural heritage (Volume II) A review of policies and practice, Council of Europe.</p> <p>ICOMOS (2004). International Charters. Conservation and Restoration, 2nd edition</p>

Titulli i lëndës:	MBËSHTJELLËSI I OBJEKIT DHE FASADA
Mesimdhënesi:	Prof.Dr. Violeta Nushi
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	Ky kurs është një hyrje intensive për disiplinën e konstruksioneve arkitektonike dhe njohurive relevante drejt të kuptuarit të konceptit,

	<p>elementeve dhe tërësisë së konstruksionit të mbështjellësit të objekteve arkitektonike në përgjithësi dhe fasadës në veçanti. Lënda zhvillohet nëpërmjet mësimave teorike dhe praktike, përmbajtja e të cilave fillimisht bëhet nga temat e zhvillimit historik, teorisë dhe praktikës së mbështjellësve, sistemeve dhe detaleve konstruktive dhe aksesoreve tjerë të mbështjellësit të objektit dhe fasadës.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Ky kurs synon të ofrojë një pasqyrë të fushës së gjerë të ndërtimit të qëndrueshëm dhe zgjidhjen efikase të mbështjellësit të ndërtesës, në kuptimin arkitektonik, ndërtimor dhe performancës energjetike. Kursi do të ofrojë një kuptim më të thellë të definicionit dhe njohurive lidhur me projektimin e elementëve të mbështjellësit, në kontekst dhe përbërje me kosto dhe performancë efektive. Kjo qasje do të ndihmon vendin, në funksionon të kontrollit të shpenzimeve për burimeve natyrore dhe energjisë, duke përdorur teknika, teknologji dhe materiale të avancuara për mbështjellësin/fasadën e ndërtesave të reja apo të vjetra, për tipologji të objekteve: shumë banesore, administrative, qendra tregtare, spitale, shkolla, etj.</p>
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> - të njoftohen me përmbajtjen kryesore të konstruksionit të elementëve arkitektonik dhe zbatimin e tyre, në mënyrë që t'i bëjë ata të aftë të projektojnë dhe të propozojnë elementin konstruktiv të mbështjellësit dhe fasadës së objekteve, sipas planeve zbatuese arkitektonike e ndërtimore. - të njoftohen për aplikueshmërinë e standardeve dhe kodeve të ndërtimit - të aftësohen për të menduar më mënyrë konstruktive gjatë sajimit të planeve zbatuese për mbështjellësin dhe fasadën e objekteve.
Metodat e mësimdhënies:	<p>Ligjërata / Leksione teorike / Seminari Ushtrime praktike – punimin e grafikëve dhe diagrameve, eventualisht modeleve, të elementëve arkitektonike e konstruktive, sipas njësisve mësimore.</p>
Metodat e vlerësimit:	<p>Vijimi i rregullt (10%); Vlerësimi i ushtrimeve/maketave (40%) Provimi final (60%); Total (përqindja mesatare) 100%. Studentët kanë të drejtë t'i nënshtrohen provimit vetëm nëse arrijnë vlerësim pozitiv në Vlerësimin e ushtrimeve.</p>
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Nushi, V. Handouts and Materials (@electronic version) after each lecture held during the courses 2. Watts, A. Facades, Technical Review. 2007 RIBA Publishing. Published by RIBA Publishing, London, UK. pp 2-69 3. Hegger, M., Fuchs, M., Stark, T., Zeumer, M. Energy Manual, Sustainable Architecture. 2008 English translation of the 1st German edition, Birkhauser Verlag AG, Basel, Switzerland. pp 38-192

	4. Kibert, Ch. J. Sustainable Construction, Green Building Design and Delivery. 2013 Jon Wiley & Sons, Inc. New Jersey, USA. pp 244-265
Literatura shtesë:	1. Szokolay, S. Introduction to Architectural Science. 2008 Third Edition, Architectural Press (Elsevier). [6] https://www.iea.org/countries/ , Technology Roadmap, Energy Efficient building envelopes. 2013, OECD/IEA, Paris, France. pp 3-53 [7] https://www.wbdg.org/guides-specifications/building-envelope-design-guide/building-envelope-design-guide-introduction#evol

Titulli i lëndës:	BIM
Mesimdhësi:	Prof.Asoc.Dr. Arta Basha Jakupi
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	Building Information Modelling (BIM) është një proces që përfshin gjenerimin dhe menaxhimin e informacionit rreth një objekti. BIM lejon një integrim të madh dhe bashkëpunim midis profesionistëve të ndryshëm, ndërtimi të disiplinave të ndryshme për të eksploruar në mënyrë digjitale dhe mund të përdoren gjatë tërë procesit të ndërtimit nga faza e projektimit deri në fazën e ndërtimit dhe madje edhe pas ndërtimit të menaxhimit të ndërtimeve.
Qëllimet e lëndës:	Ky kurs do t'i ofrojë studentit mundësi të shumta të të mësuarit për të zgjeruar njohuritë dhe përvojën e tyre inxhinierike. Ne do të përqendrohemi në fushat teknike dhe profesionale të inxhinierisë.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> - demonstrojnë njohuri për proceset dhe përfitimet e BIM-it; - pajisjen me njohuri praktike të 3D BIM modelimit arkitektonik - demonstrojnë shkathtësi dhe njohuri teknike për të filluar dhe mbështetur një projekt duke përdorur BIM; - krahasojnë dhe dallojnë njohuritë e komponenteve të ndryshme arkitekturore dhe teknologjike - zhvillimi i fjalorit të ndërtimit dhe të infrastrukturës për të qenë në gjendje të përshkruajë një ndërtesë, përbërësit sistemet e tij, duke përfshirë komponentët e arkitekturës, MEH (mekanike, elektrike, hidraulike) dhe strukturore. - përshkruajnë evolucionin dhe zhvillimin e BIM-it deri në ditët e sotme. - shpjegojnë sfidat dhe pengesat që ende ballafaqohen me përdorimin e BIM.
Metodat e mësimdhënies:	Klasat do të kombinojnë leksione interaktive, tutoriale, diskutim, punë praktike, analizë të rasteve studimore, punë seminare dhe punë laboratorike. Puna zhvillohet në grupe tematike, ndërsa projekti është individual ose në grupe.
Metodat e vlerësimit:	Prezenca e studentit 5%; Vlerësimi i Parë 35%; Vlerësimi i dytë 35%; Puna individuale 25%, provimi përfundimtar për ata që nuk kanë kaluar vlerësimin e parë dhe të dytë.

Literatura primare:	Eastman Ch., et al(2011) BIM Handbook: A Guide to Building Information Modeling for Owners, Managers, Designers, Engineers and Contractors, Wiley
Literatura shitesë:	Kensek, Karen and Noble, Douglas (2014). Building Information Modeling: BIM in Current and Future Practice, Wiley. Cranbourne Ch., et al (2016) Implementing Virtual Design and Construction using BIM: Current and future practices, Routledge Kensek M. K., (2014) Building Information Modeling, Routledge

Titulli i lëndës:	PROJEKTIM STUDIO - OBJEKTET SHËNDETËSORE
Mesimdhësi:	Prof.Asoc.Dr. Vlora Navakazi
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Kredite ECTS:	8
Përshkrimi i lëndës:	Përmbajtja e metodologjisë, klasifikimi, zhvillimi historik i shëndetësisë, planifikimi i rrjetit, lokacioni dhe detyrat programore për projektimin e objekteve shëndetësore. Spitalet, llojet, kapaciteti, funksioni, rrjeta, lokacioni, struktura dhe organizimi i tyre. Poliklinika, koncepti bashkëkohor i ndërtimit, urbanizimi, sistemi i ndërtimit, dimensionet dhe fleksibiliteti.
Qëllimet e lëndës:	Njoftimi i studentëve me objektet shëndetësore, elementet organizative, standardet projektuese në kontekstin më të gjerë urban si dhe në atë të ngushtë të vet objektit si dhe aftësi dhe qasja e tyre në problematikën e projektimit të këtyre objekteve.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Me përfundimin e këtij kursi studenti do të ketë mundësi të: - Zotëroj bazat e projektimit konceptual dhe urban-arkitektonik; - Zbatoj metodologjitë e projektimit arkitektonik; - Zhvilloj qasje kreative individuale për zgjidhjen e problemeve; - Aplikoj analizën e problemeve; - Hulumtoj dhe shfrytëzoj materiale dhe teknologji tradicionale dhe bashkëkohore;
Metodat e mësimdhënies:	Ligjerata, mënyra multimediale e prezentimit, komentimi analitik dhe krahasimi përmes të mjeteve të konkretizimit si projektori, llaptopi, tabela; ushtrimet e organizuara me punë në grupe (2 deri 3 studentë); vizita në teren, detyra individuale nën mbikëqyrje.
Metodat e vlerësimit:	Me dorëzimin dhe vlerësimin pozitiv të punimit individual/grupor, studenti fiton të drejtën e nënshkrimit. Kriteret e vlerësimit dhe kalueshmërisë në : Prezenca në ligjerata dhe aktiviteti në ushtrime (10%), eseu (15%), Kolokiumi (15%); projekti Individual/grupor (2-3 studentë) (55%); Provimi përfundimtar (5%).
Literatura primare:	1. Adler, D., Metric Handbook – Planning and Design Data (second edition), Architectural Press, Oxford, 2000; 2. Baiche, B. Walliman, N., Neufert-Architects' Data (third edition), Oxford, 2000; Ferster Marmot, A. 3. Nesmith, E.L., “Health care architecture design for future”, AIA, 1995;

	4. "HOSPITALS design and development", The AP:London 5. Summary of lectures, "health facilities", Dr.sc.Vlora Navakazi 6. Përmbledhje e ligjeratave, "Objektet shëndetësore", Dr.sc.Vlora Navakazi
Literatura shtesë:	9. Dirichlet Labryga Poelzig Schlenzig, HOSPITALS design and development , 10. The AP:London KRANKENHAUS BAU /, Institut K.der T.Univ.Berlin; 11. HEALTH CARE ARCHITECTURE designs for the future/E.L.Nesmith; 12. Juračić, D., Zgrade za zdravstvo, Arhitektonski fakultet Sveučilište u Zagrebu, 2002.

Titulli i lëndës:	PROJEKTIM STUDIO - QENDRAT PËR HULUMTIM DHE LABORTORET
Mesimdhësi:	Prof.Asoc.Dr. Vlora Navakazi
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Kredite ECTS:	8
Përshkrimi i lëndës:	Kursi Projektim Studio: Qendrat për Hulumtim dhe Labororet diskuton dhe studion temën e projektimit të Qendrave për Hulumtim dhe Labororet. Kursi zhvillohet një herë në javë dhe është kurs i integruar me pjesëmarrje interaktive të studentëve. Roli kryesor i kursit është të studiojë dhe të hulumtojë tipologjinë e komplekseve dhe parqeve shkencore së bashku me labororet përcjellse – strukturat multifunkionale bashkëkohore, me theks në tipologjinë: qendrat për hulumtime shkencore, parqet shkencore-akademike, stacionet Radiodifuzive dhe TV , forenzikën, CGI-modelimin kompjuterik, institute të ndryshme, kurse tipologjinë e strukturave multifunkionale do të caktohen për çdo vit akademik sipas trendeve aktuale në bashkëpunim me studentët dhe referencat ndërkombëtare akademike.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kursit është të inicojë, të përdorë parimet themelore teorike dhe praktike arkitekturore të projektimit, duke përfshirë ndërlidhjen simbiotike të avancimit të teknologjisë, stilit të jetesës bashkëkohore, dhe projektimit arkitektonik. Objektivat kryesore të kursit janë subjekt i qasjeve të ndryshme ndërdisiplinore për të zgjidhur problemet e projektimit arkitektonik, duke ndarë proceset krijuese si një qasje për të identifikuar dhe zgjidhur varietetet e problemeve në Arkitekturë.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të kursit, studentët duhet të kenë kuptuar dhe zotëruar parimet themelore projektuese të komplekseve multifunkionale - Qendrat për Hulumtim dhe Labororet: <ul style="list-style-type: none"> - Studentët kanë zhvilluar aftësitë e nevojshme për projektim e komplekseve multifunkionale me fokus në Qendrat për Hulumtim dhe Labororet; - Studentët kanë zhvilluar aftësi dhe teknika për të përshkruar, analizuar dhe artikuluar procesin e projektimit ndërdisiplinor.
Rëndësia dhe Aktualiteti i Lëndës	Kursi, Projektim Studio: Qendrat për Hulumtim dhe Labororet, promovon dhe inicon kuptuarjen e njohurive themelore, dhe të avancuara të projektimit arkitektonik. Tematika e shtjelluar në kurs korespondon, dhe aktualisht është në vijë me trendet bashkëkohore të mësimdhënjes në

	universitetet europiane dhe më gjërë. Studentët janë të pajisur me literaturën primare në gjuhën Shqipe falas, nga mësuesi i kursit.
Metodat e mësimit:	Mësuesia ka karakterin e diskutimeve interaktive, duke angazhuar në diskutim të gjithë studentët. Gjithashtu, kursi synon që studentët të marrë pjesë në punë në grup, dhe individuale, të cilët do të marrin detyra konkrete në formën e projekteve ideore arkitektonike. Ligjëratat, dhe ushtrimet gjatë mësimit në klasë përdorin mjete dhe teknika të ndryshme vizuale, kurse gjatë punës me studentë në konsultimet individuale promovohet dhe vlerësohet puna e pavarur në klasë, si dhe angazhimi dhe detyrat e shtëpisë.
Metodat e vlerësimit:	Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë për kursin: <ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja e studentit në ligjerata dhe ushtrime, aktiviteti ... 15% - Vlerësimi obligativ intermediar - Fazat 15% - Portfolio e punimeve grafike, detyrave, seminareve, të vlerësuar me notë - pozitive gjatë semestrit, janë kusht për të marrur ECTS – si dhe janë kusht - për t'iu nënshtruar provimit përfundimtar 40% - Provimi përfundimtar, Test me shkrim. 30%
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 4. Bujar Bajçinovci, Sustainable Architectural Design – principles, 4 (3), JOSHA, 2017. 5. Bujar Bajçinovci, Research Centers and Laboratories, Architectural Design – principles, 4 (5), JOSHA, 2017. DOI: 10.17160/josha.4.5.355 6. Bujar Bajçinovci, Research Centers and Laboratories-Part 2, Architectural Design – principles, 5 (3), JOSHA, 2018. DOI: 10.17160/josha.5.3.414
Literatura shtesë:	2. Amaresh Chakrabarti, Udo Lindemann, Eds. Impact of Design Research on Industrial Practice. (2016). Springer International Publishing Switzerland

Titulli i lëndës:	PROJEKTIM STUDIO - STRATEGJITË E PROJEKTIMIT
Mësuesi:	Prof.Ass.Dr. Arta Xhambazi
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Kredite ECTS:	8
Përshkrimi i lëndës:	<p>Lënda paraqet shembuj të përzgjedhur të detyrave projektuese komplekse dhe specifikacionet e tyre dhe jep një pasqyrë rreth metodave aktuale të projektimit.</p> <p>Duke filluar nga një diskutim i shembujve të zgjedhur të llojeve të ndryshme të ndërtesave, lënda ofron një hyrje në analizën dhe specifikimin e programeve komplekse, si dhe një pasqyrë të metodave bashkëkohore të projektimit. Tipologjia e ndërtimit dhe teoritë e ndërlidhura nuk diskutohen si një enciklopedi autoritative e normave dhe rregulloreve, por ato janë konceptuar si një bazë e njohurive për risitë programore dhe</p>

	metoda të reja të projektimit, duke përgatitur studentët për një vlerësim kritik të kufizimeve kontradiktore të projektimit.
Qëllimet e lëndës:	Një edukim kritik lidhur me ballafaqimi me kushtet dhe kërkesat e kontradiktoreve të projektve të ndërtimit; trajnim i metodave për të analizuar dhe zhvilluar programe funksionale për tipologji specifike të ndërtimit , përkatësisht trajnimi për kompetencat e projektimit; si dhe aftësimi për të kontribuar në diskursin kritik të parimeve arkitektonike.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të kursit studenti: <ul style="list-style-type: none"> – njeh zhvillimin e fushë së arkitekturës lidhur me konceptet dhe metodat kryesore teorike për arkitekturën dhe projektimin, – reflekton në mënyrë kritike për qasjet e ndryshme kërkimore-shkencore në disiplinën e arkitekturës, në një kontekst të marrëdhënieve të shumëllojshme midis arkitekturës, qytetit dhe shoqërisë – demonstroi njohuri të mjaftueshme për procesin e projektimit si dhe argumenton dhe reflekton mbi marrëdhëniet ndërmjet analizave, konceptimit, metodave/strategjive të projektimit dhe projektit. – pozicionon projektin brenda një kuadri të veçantë teorik, historik, social ose kontekstual.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjerata, puna në terren, hulumtimi arkivor, analiza të rasteve studimore, punë seminarike dhe punë studio. Hulumtimi zhvillohet në grupe tematike, ndërsa projekti është individual ose në grupe.
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimet bazohen në performancën e përgjithshme brenda studios e cila përcaktohet nga cilësia e punës, përkushtimit, punës ekipore, përpjekjeve dhe përmirësimeve gjatë tërë semestrit. Aspektet konkrete për vlerësim janë: puna kërkimore, formulimi i argumenteve, shndërimi i argumenti në koncept, projekti arkitektonik, prezantimi.
Literatura primare:	Xhambazi A. (2018). Arkitektura u kontekstu savremenih perspektiva konceptualizacije i materijalizacije. Disertacion i doktoratës, Fakulteti i Arkitekturës Sarajevë Baker, G.H. (1996). Design Strategies in Architecture: an approach to the analysis of form.(2nd ed.). London and New York: Routledge Bielefeld, B.& El Khouli, S. (2007) Basic Design Ideas. Basel, Boston: Birkhäuser. Foqué, R. (2010). Building Knowledge in Architecture. Brussels: University Press Antwerp Groat, L., & Wang, D. (2013). Architectural Research Methods (2nd ed.). New York: John Wiley & Sons. Jormakka, K. (2008). Basics Desing Methods. Basel, Boston, Berlin: Birkhäuser. Moneo, R. (2004). Theoretical Anxiety and Design Strategies: in the Work of Eight Contemporary Architects. Cambridge and London: The MIT Press
Literatura shtesë:	Geiser, R. (Ed.). (2008). Explorations in Architecture: Teaching Desing Research. Birkauser: Basel, Boston, Berlin.

	<p>Plowright, Ph.(2014). Revealing Architectural Design: Methods, Frameworks and Tools. New York, NY: Routledge</p> <p>Schumacher, P. (2012). The Autopoiesis of Architecture, Volume II: A New Agenda for Architecture. West Sussex, United Kingdom: John Wiley & Sons Ltd</p>
--	---

Titulli i lëndës:	STUDIO - ARKITEKTURA E QENDRUESHME
Mesimdhënesi:	Prof.Dr. Violeta Nushi
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	6
Përshkrimi i lëndës:	<p>Kursi Studio: Arkitektura e Qëndrueshme, diskuton dhe studion fushën e arkitekturës që kërkon të minimizojë ndikimin negativ mjedisor të ndërtesës me efikasitet dhe modelim në përdorimin e materialeve, hapësirës për energji dhe zhvillim dhe ekosistemit në përgjithësi. Lënda paraqet bazat e arkitekturës dhe ndërtimit të qëndrueshëm, nëpërmjet të dhënave të studimeve të rasteve dhe përkufizimet për: fiziologjinë njerëzore, klimatologjinë dhe fizikën e ndërtimit; metodat dhe teknikat e arkitekturës së qëndrueshme tradicionale; arkitekturës dhe teknologjisë së ndërtimit dhe materialeve; burimet energjetike dhe energjia e ripërtirueshme; konsumi i energjisë në ndërtesa; teknologji mjedisore (e gjelbër) në mjedisin e ndërtuar; dhe analizën e ciklit të jetës.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimet e kursit (modulit): Të ofrojë studentëve një pasqyrë të fushës së gjerë të arkitekturës dhe ndërtimit të qëndrueshëm; për të analizuar ndikimin mjedisor të arkitekturës dhe zhvillimeve të ndërtimit në mjedisin e ndërtuar; për të nxjerrë në pah aspekte të ndryshme të qëndrueshmërisë dhe t'i integrojë ato drejt arkitekturës dhe ndërtimit të qëndrueshëm.</p>
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi, studentët duhet të jenë në gjendje që në fushën e arkitekturës dhe ndërtimeve të qëndrueshme të dijnë: çfarë është zhvillimi i qëndrueshëm në mjedisin e ndërtuar, përkufizimi i tij, karakteristikat, objektivat; metodat dhe kuptimi shkencor kundrejt metodës së projektimit dhe zbatimit të tyre; për të përdorur informacionin teorik për të hartuar një model të të dhënave të mbledhura që karakterizojnë një arkitekturë dhe ndërtim të qëndrueshëm.</p>
Metodat e mësimdhënies:	<p>Metodat e mësimdhënies do të përfshijnë ligjerata, seminare, debate dhe punëtori - punë projekti për student, me punë të pavarur në klasë, dhe detyra shtëpie individuale. Lënda do të përfshijë aktivitete teorike dhe praktike dhe do të jetë kryesisht interaktive, duke angazhuar në diskutim të gjithë studentët, eventualisht akademinë dhe pjesëmarrësit e komunitetit. Për ligjerata dhe ushtrimet përdoren teknika dhe mjete të ndryshme vizuale.</p>
Metodat e vlerësimit:	<p>Metodat e vlerësimit dhe kriteret e përshtatshmërisë për kursin:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja e nxënësve dhe vlerësimi i aktivitetit 15% - Vlerësimi ndërmjetës 15% - Portfolio e veprës grafike, të vlerësuar me notë pozitive - gjatë semestrit, si kusht për të fituar të drejtën për provim, 40% - Provimi përfundimtar, provimi me shkrim 30%

Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Leksione të përgatitura nga Prof. Dr. V. Nushi 2. Kibert, Ch. J., "Sustainable Construction: Green Building Designs and Delivery", 2007 3. Williamson, T., Radford, A., Bennetts, H., 'Understanding Sustainable Architecture', 2003 4. Williams, D.E.; Orr, D.W., "Sustainable Design: Ecology, Architecture and Planning", 2007
Literatura shitesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. McLennan, J. F., "The Philosophy of Sustainable Design", 2004

Titulli i lëndës:	STUDIO - TRAJTIMI PREVENTIV I NDËRTESAVE
Mesimdhënesi:	Prof.Dr. Violeta Nushi
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	6

Përshkrimi i lëndës:	<p>Lënda adreson qasjet themelore, parimet dhe praktikat e trajtimit preventiv të strukturave të ndërtuara, me fokus në ndërtesat historike. Konsolidimi inventiv strukturor i ndërtesave përbën hapin primar në procesin e veprimeve që ndërlidhen me ndërhyrjet konservuese-restauruese, dhe prandaj njohja e mirë e performancës optimalizimit strukturor është qenësor në mbrojtjen dhe jetëgjatësinë e ndërtesave. Lënda është konceptuar që të informojë studentët lidhur me sfidat e intervenimit shkencor dhe inventiv në ndërtesa historike nëpërmjet teknikave dhe materialeve për trajtim preventiv, me qëllim të kualifikimit, vlerësimit dhe zbutjes efektive të rreziqeve dhe dëmeve strukturale në ndërtesa historike. Studentët do të njihen me qasjen gjithëpërfshirëse dhe sistematike për ruajtjen parandaluese, arsyetimin e ruajtjes parandaluese në botë dhe në veçanti në Kosovë, praktikat e rekomanduara, agjentët e përkeqësimit, kontrollit dhe monitorimit, si dhe do të aftësohen në përgatitjen e projektit të trajtimit preventiv të ndërtesës.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi i lëndës është që studentët të aftësohen në identifikimin dhe zbutjen e dëmeve të jashtme dhe të brendshme në ndërtesa dhe të aftësohen në përcaktimin e shkallës dhe llojit të trajtimit preventive. Gjithashu, që studentët të aftësohen në marrje vendimi të bazuar por edhe të shpejtë për mirëmbajtje, kontroll dhe monitorim, dhe konsolidim strukturor, varësisht nga shkalla e identifikuar e rrezikshmërisë në ndërtesë.</p>
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që të:</p> <ul style="list-style-type: none"> – aplikojë llojet e trajtimit preventiv në varësi prej shkallës së dëmtimeve në ndërtesë – krijojë qasje të bazuar në propozimet dhe masat konsoliduese dhe monitoruese varësisht nga qëllimi i trajtimit dhe përdorimit të ndërtesës – zhvillojë sensin e intervenimit imediat në kushtet e përkeqësimit të shpejtë të ndërtesës në situata risku apo emergjence

Metodat e mësimdhënies:	Ligjerata tematike, diskutime, punëtori me ligjërues të ftuar, vizita në terren, projekti i intervenimit preventiv të ndërtesës si detyrë semestrale.
Metodat e vlerësimit:	Vijueshmëria e studentit dhe angazhimi aktiv në klasë 10%, Detyrat semestrale dhe prezantimet e studentëve 60%, Vlerësimi nga testet 15% ose Provimi final 30%
Literatura primare:	Chris Caple (2000). Conservation Skills: Judgement, Method and Decision Making, Routledge Michael Forsyth Ed. (2008). Materials & skills for historic building conservation, Blackwell Publishing Ltd HeritageCare (2017). General methodology for the preventive conservation of cultural heritage buildings, InterregSudoe
Literatura shitesë:	Eric May, Mark Jones (2006). Conservation Science: Heritage Materials, RSC Paperbacks D. A. Scott, Et.al. Eds. (1994). Ancient & Historic Metals. Conservation and Scientific Research, The Getty Conservation Institute M. Hosseini, I. Karapanagiotis Eds. (2018). Advanced Materials for the Conservation of Stone, Springer C.V. Horie (1990). Materials for Conservation. Organic consolidants, adhesives and coatings, Butterworths L. Uzielli Ed. (2009). Wood science for conservation of cultural heritage, Firenze University Press

Titulli i lëndës:	LABORATORI I DIZAJNIT KOMPJUTERIK
Mesimdhënesi:	Prof.Asoc.Dr. Arta Basha Jakupi
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	6
Përshkrimi i lëndës:	Kjo lëndë paraqet një qasje kompjuterike ose gjeneruese për të dizajnuar përdorimin e formave gramatikore. Forma gramatikore ishin një nga të parat dhe mbetet një nga sistemet e pakta të dizajnit kompjuterik që janë tërësisht vizuale, sesa tekstuale apo numerike. Ato sigurojnë një mjet të fuqishëm për analiza dhe sintezë të dizajnit, për eksplorimin e dizajnit dhe për gjenerimin e zgjidhjeve të dizajnit të ri. Bazat e formave gramatikore do të futen përmes leksioneve dhe përmes ushtrimeve në klasë. Një gamë e aplikacioneve nga analiza stilistike deri tek dizajni kreativ do të hulumtohet. Do të paraqiten programe kompjuterike për format gramatikore.
Qëllimet e lëndës:	Përtej aplikimit të teknikave dhe mjeteve digjitale, përpjekjet e projektimit kompjuterik punojnë për të rishikuar marrëdhënien midis përshkrimit formal, ndërtimit sistematik, analizës së performancës dhe prodhimit industrial. Dizajni kompjuterik hulumtohet si një mjet për identifikimin dhe kodimin e këtyre dimensioneve diskrete të dizajnit në një projekt sintetik të projektimit, inxhinierisë, fabrikimit dhe banimit.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	- njohuri dhe ekspertizë në dizajnin kompjuterik dhe fabrikimin digjital në lidhje me projektimin e ndërtesave dhe arkitekturës në përgjithësi. Kurset

	<p>mbulojnë programimin për dizajnin kompjuterik dhe fabrikimin digjital duke përdorur mjetet CNC të prerjes (printerat 3D, kuti laserike etj.)</p> <p>- zhvillimi i mendimit kritik për metodologjitë specifike të projektimit, aplikimet aktuale dhe përparimet në zhvillim në fushën e dizajnit kompjuterik dhe fabrikimit digjital.</p> <p>- njohja dhe identifikimi i efektit të këtyre metodologjive dhe aplikimeve në prodhimin e mjedisit të ndërtuar.</p> <p>- Tregon origjinalitet në aplikimin e analizave dhe njohurive kërkimore në fushën e dizajnit kompjuterik dhe fabrikimit digjital përmes projekteve të projektimit.</p>
Metodat e mësimdhënies:	<p>Klasat do të kombinojnë leksione interaktive, tutoriale, diskutim, punë praktike, analizë të rasteve studimore, punë seminare dhe punë studimore. Çdo klasë ka një sërë leximi, dhe është e rëndësishme që studentët të vazhdojnë me leximet dhe të jenë të përgatitur për t'i diskutuar ato në klasë. Hulumtimi zhvillohet në grupe tematike, ndërsa projekti është individual ose në grupe.</p>
Metodat e vlerësimit:	<p>Prezenca e studentit 5%; Vlerësimi i Parë 35%; Vlerësimi i dytë 35%; Puna individuale 25%, provimi përfundimtar për ata që nuk kanë kaluar vlerësimin e parë dhe të dytë.</p>
Literatura primare:	<p>T. W. Knight, (1994) Transformations in Design (Cambridge University Press, Cambridge)</p>
Literatura shtesë:	<p>Menges A. & Ahlquist S., (2011) Computational Design Thinking: Computation Design Thinking, Wiley</p> <p>Leach N. & Yuan F.P., (2018) Computational Design, Tongji University Press Co</p> <p>Wassim J., (2013) Parametric Design for Architecture, Laurence King Publishing</p>

Titulli i lëndës:	SUPERSTRUKTURAT ORGANIKE NË PROJEKTIM
Mesimdhënesi:	Prof.Dr. Violeta Nushi
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	<p>Vështrimi i projektvet të arkitektëve më emeninet bashkëkohorë tregon zhvendosje nga format themelore të konceptimit dhe materializimit arkitektonik, në struktura më komplekse, jo të rregullta dhe tendencën për krijimin e formave jo standarde dhe dinamike. Edhe pse shprehjet formale të këtyre projekteve bëhen frymëzim për studentët e rinj dhe arkitektët, lënda argumenton se këto ndryshime nuk janë vetëm çështje teknike dhe teknologjike, por edhe metodologjike, shkencore dhe intelektuale, që vijnë si rezultat i zhvillimeve të fundit teknologjike, argumenteve shkencore dhe ndikimit filozofik.</p> <p>Në këto kushte dhe me ndërmjetësimin e kompjuterit koncepti i hapësirës ka ndryshuar dhe qëllimisht është zhvendosur nga "bërja" në "gjetjen" e formës në arkitekturë, koncept ky i lidhur ngushtë e lidhur edhe me procesin e ndërtimit.</p>

Qëllimet e lëndës:	Trajtimi i koncepteve gjenerative morfogjenetike (topologjia, dizajni parametrik, sipërfaqet izomorfike, arkitektura metamorfike dhe evolutive) si dhe arkitektura algoritmike; si dhe hulumtimi i mundësive të përdorimit të këtyre modeleve në procesin e dizajnit të formës arkitektonike.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Në fund të kursit studenti: <ul style="list-style-type: none"> – Kupton se përtej shprehjes formale të superstrukturave organike ekzistojnë edhe vetitë kompjuterike dhe kombinatorike që mund të konsiderohen si zgjerim i mendimit njerëzor. – Diferencon konceptet dhe funksionet e modeleve morfogjenetike dhe algoritmike – Analizon proceset gjenerative të precedentëve bashkëkohore – Zhvillon mendimin konceptual në një nivel më të lartë të kompleksitetit, brenda kornizave të teorive bashkëkohore
Metodat e mësimdhënies:	Ligjerata, punë seminarike, realizimi i punimit seminarik. Gjatë ligjeratave dhe punës seminarike nga studenti pritet të studiojë literaturën e dhënë paraprakisht në mënyrë që ligjerata dhe puna në seminar të përcillet në mënyrë aktive.
Metodat e vlerësimit:	Diskutimet në seminare, prezantimi dhe mbrojtja e punës seminarike.
Literatura primare:	Carpo, M.ed. (2013). The Digital Turn in Architecture 1992–2012, United Kingdom, Chichester: John Wiley & Sons Kolarević, B. (Ed.). (2003). Architecture in the Digital Age: Design and Manufacturing. New York & London: Spon Press. Moussavi, F. (2009). The Function of Form. Barcelona Spain and Cambridge, Massachusetts: ACTAR and Harvard University Graduate School of Design. Terzidis, K. (2003). Expressive Form: A conceptual approach to computational design. London and New York: Spon Press. Terzidis, K. (2006). Algorithmic Architecture. Burlington, Massachusetts: Architectural Press. Exuberance: New Virtuosity In Contemporary Architecture. Architectural Design. (80/2), (March/April, 2010), Wiley. The New Structuralism: Design, Engineering and Architectural Technologies. Architectural Design. 80(4), (July/August, 2010), Wiley Mathematics of Space. Architectural Design. 81(4), (July/August 2011), Wiley
Literatura shtesë:	Agkathidis, A. Generative Design: Form-finding Techniques in Architecture (Form + Technique) (2015). England, London: Lorence King Publishing Ltd. Nesbitt, K. (Ed.). (1996). Theorizing a New Agenda for Architecture: An Anthology of Architectural Theory 1965-1995. New York: Princeton Architectural Press. Sykes, A. K. (Ed.). (2010). Constructing A New Agenda: Architectural Theory 1993-2009. New York: Princeton Architectural Press.
Titulli i lëndës:	NDIKIMI I NDËRTESAVE NË MJEDIS
Mesimdhënesi:	Prof.Ass.Dr. Mimoza Dugolli
Statusi i lëndës:	Obligative

Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	Kohët e fundit, ndryshimet klimatike dhe ngrohja globale janë bërë temat më të nxehta në mbarë botën. Ndërtimi i ndërtesave të reja dhe / ose menaxhimi i objekteve ekzistuese duhet të përshtaten për të reaguar ndaj çështjeve të tilla mjedisore globale. Ky kurs do të japë informacion rreth qasjes që redukton efektet e pafavorshme të ndërtesave në mjedis, duke siguruar mjedise të ndërtuara me cilësi. ISO përcakton 'mjedisin' si një mjedis ku vepron një organizatë, duke përfshirë ajrin, ujin, tokën, burimet natyrore, florën, faunën, njerëzit dhe ndërlidhjen e tyre. Rrethi, në këtë kontekst shtrihet nga brenda organizatës deri në sistemin global. Ndikimi mjedisor është çdo ndryshim në mjedis, qoftë i kundërt ose i dobishëm, që rezulton tërësisht ose pjesërisht nga aktivitetet, produktet ose shërbimet e një organizate. Një aspekt i rëndësishëm mjedisor është një aspekt mjedisor që ka ose mund të ketë një ndikim të rëndësishëm mjedisor. Ky kurs adreson çështjet për të cilët ekziston dëshmi e mirë e problemeve mjedisore që ato shkaktojnë dhe për të cilat mund të përcaktohen kritere objektivisht të arritura të performancës.
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi i këtij kursi është që studentët në thelb të kuptojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Si mund të rritet siguria, të përmirësohet higjiena dhe cilësia e ambienteve të brendshme si dhe shëndeti dhe mirëqenia e banorëve; • Si të minimizohet ndotja e ambienteve të jashtme; • Promovimi dhe inkurajimi i ndërtesave, sistemeve dhe pajisjeve efikase të energjisë, • Si të reduktohet konsumi i paqëndrueshëm i resurseve gjithnjë e më të pakta siç janë uji dhe druri; • Si të përmirësohet menaxhimi i mbetjeve dhe të inkurajohet riciklimi dhe ripërdorimi i materialeve. • Si të sigurohet vlerësimi për ndërtesat ku cilësia është përmirësuar dhe ndikimet mjedisore janë zvogëluar; • Si t'i aftësojmë zhvilluesit dhe operatorët e ndërtimit që t'i përgjigjen kërkesave të përdoruesve për ndërtesa më cilësore që kanë më pak ndikim në mjedis; dhe • Si të ndihmohet stimulimi i tregut për ndërtesa më të qëndrueshme.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përcaktojnë shkallën në të cilën aspektet mjedisore të lidhura me lokacionin janë të rëndësishme dhe mund të adresohen në vlerësim. Aspektet e lokacionit përfshijnë: lokacionin dhe dizajnin e ndërtesës; shkarkimet nga vendi; dhe menaxhimi i lokacionit. • Ngjashëm me çështjet e lokacionit, çështjet e përdorimit të materialeve do të jenë të ngjashme për të gjitha llojet e ndërtesave, megjithëse madhësia e ndërtesës do të ketë rëndësi. Materialet përfshijnë: përzgjedhjen e materialeve; përdorimi efikas i materialeve; dhe deponimin dhe riciklimin e mbeturinave. • Vlerësimi i përdorimit të ujit që përfshinë cilësinë dhe karakteristikat që përmirësojnë shfrytëzimin dhe zvogëlojnë rrjedhjen, domethënë: cilësinë e ujit; ruajtja e ujit; dhe shkarkimet e shkarkimeve.

	<ul style="list-style-type: none"> • Adresimi i çështjeve të brendshme që ndikojnë në shëndetin, komoditetin ose mirëqenien e banorëve, si dhe aspektet e performancës që përmirësojnë cilësinë dhe funksionalitetin. Nuk përfshihen aspektet teknike të performancës së lokaleve të specializuara, siç janë cilësitë akustike të mjediseve të koncerteve, ndriçimi i skenave ose cilësia e ajrit në dhomat e pastra. Cilësia e ambientit të brendshëm (IEQ) përfshin: sigurinë; higjiena; cilësinë e ajrit të brendshëm dhe ventilimin; rehati termike; ndriçim; akustikë dhe zhurmë; dhe pajisje ndërtimi. • Inovacioni që demonstroi rritjen e performancës, nëpërmjet përmirësimit të efikasitetit dhe / ose përmirësimeve në mjedisin e ndërtuar.
Rëndësia dhe Aktualiteti i Lëndës	Rëndësia e këtij kursi është jo vetëm që nxënësit mësojnë të vlerësojnë performancën aktuale të një ndërtese, por edhe sepse jep një udhëzim mbi performancën e mundshme, domethënë performancën më të mirë që mund të merret nga ndërtesa duke pasur parasysh nivelet mbizotëruese të banimit dhe natyrën e përdorimit, me ndikim minimal mjedisor.
Metodat e mësimdhënies:	Mësimdhënia do të realizohet përmes leksioneve, ushtrimeve, detyrave të grupit, vizitave në terren.
Metodat e vlerësimit:	Shkalla e kalimit të kursit është 60%. Pjesëmarrja e studentëve 10%; Caktimet individuale të kryera në klasë 15%; Detyrat e shtëpisë të kryera në shtëpi 15%; Vlerësimi me teste 60%; Provimi përfundimtar 100%.
Literatura primare:	Lectures from the profesor, Thomas Carpenter “Environment, Construction and Sustainable Development” 1st Edition, Chris Magwood “Making Better Buildings: A Comparative Guide to Sustainable Construction for Homeowners and Contractors”,
Literatura shitesë:	Construction Industry Research & Information Association “Environmental Impact of Building and Construction Materials”: SP116 (Special Publication).

Përshkrimi i lëndës:	Digjitalizimi i trashëgimisë kulturore i referohet fushës dinamike dhe zhvillimore ndërdisiplinore që përfshin aspektet filozofike, sociale, kulturore, ekonomike dhe menaxheriale të trashëgimisë kulturore në mjedisin teknologjik. Lënda ofron udhëzime gjithëpërfshirëse në këtë temë që studentët të përgatiten për një qasje më të avancuar dhe bashkëkohore në procesin e dokumentimit digjital të trashëgimisë kulturore. Mbështetur në trendet aktuale, lënda eksploron aspekte të një modeli konceptual për studimet e digjitalizimit të trashëgimisë kulturore, që angazhohet në aplikimin e mjeteve teknologjike në funksion të vlerësimit të aspekteve sociale dhe njerëzore në studimet e trashëgimisë kulturore. Sot, historia urbane, dokumentimi grafik i trashëgimisë arkitekturale dhe historia kulturore përbëjnë fushat kryesore të shkencës humane digjitale. Modeli i sugjeruar bazohet në një koncept të integruar të komunikimit të kujtesës që pasqyron natyrën komplekse të fenomenit të trashëgimisë kulturore dhe parasheh sinergjitë midis trashëgimisë digjitale dhe aspektit njerëzor në fushën trashëgimisë.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i lëndës është nxitja e diskutimit për integrimin e disiplinave të digjitalizimit në fushën e trashëgimisë kulturore. Në funksion të këtij qëllimi, lënda stimulon përfshirjen e përvajave në përdorimin e teknologjive dhe metodave inovative për dokumentim, menaxhim, dhe komunikim të trashëgimisë kulturore
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> – transformojë të dhënat fizike dhe sociale në një format digjital – dokumentojë lokalitetet, monumentet, si dhe elementet tjetër të trashëgimisë materiale dhe jomateriale në një format digjital – identifikojë teknikat e nevojshme për dokumentimin, interpretim, prezantim dhe promovim të trashëgimisë kulturore në formatin digjital, si dhe të kuptojë kapacitetet dhe mundësitë e trashëgimisë digjitale
Metodat e mësimdhënies:	Ligjerata tematike, diskutime, vizita studimore, puna në IT laborator, detyra semestrale në kategoritë dhe nivelet e digjitalizimit
Metodat e vlerësimit:	Pjesëmarrja e studentëve dhe angazhimi aktiv në klasë 10%, Punimet Semestrale dhe prezantimet e studentëve 60%, Vlerësimi nga testet 15% ose provimi përfundimtar 30%
Literatura primare:	Sander Münster Et.al. (Eds.) (2018) Digital Research and Education in Architectural Heritage, Springer D. Lu, Y. Pan. (2010) Digital Preservation for Heritages. Technologies and Applications, Springer M. Zhou, G. Geng, Z. Wu (2012), Digital Preservation Technology for Cultural Heritage, Springer Marinos Ioannides et.al. (Eds.) (2014) Digital Heritage. Progress in Cultural Heritage: Documentation, Preservation, and Protection, Springer
Literatura shtesë:	A. Bentkowska-Kafel, L. MacDonald, (2018), Digital Techniques for Documenting and Preserving Cultural Heritage, Arc Humanities Press, UK

	E. Stylianidis, F. Remondino (2016). 3D Recording, Documentation and Management of Cultural Heritage, Whittles Publishing Basic Guidelines for Cultural Heritage Professionals in the Use of Information Technologies, http://www.enamecenter.org/files/documents/Know-how%20book%20on%20Cultural%20Heritage%20and%20ICT.pdf
--	--

Titulli i lëndës:	PROJEKTIMI NË KONTEKST KULTUROR
Mesimdhësi:	Prof.Asoc.Dr. Vlora Navakazi
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	Me qëllim të projektimit të ndërtesave të kulturës në kontekst më rrethinën e mbrojtur të trashëgimisë së një vendi, në kuadër të specializimit të trashëgimisë studenti do të arrijë njohuritë me specifikat, karakteristikat, përmbajtjet programore dhe metodat e projektimit të objekteve të kulturës. Përmbajtja e metodologjisë, klasifikimi dhe zhvillimi historik i objekteve të teatrit dhe operës, qendrat për aktivitetet kulturore, bibliotekat, ndërtesat për ekspozim muzetë dhe galeritë, kinematë, ndërtesat kulturore multifunksionale, si dhe rehabilitimi i trashëgimisë industriale në funksione të tipologjive të aktiviteteve kulturore . Përveq zhvillimit historik, shtrirjes dhe rrjetit të shpërndarjes së këtyre objekteve të kulturës, studentët do të njihen edhe me karakteristikat specifike të zgjidhjeve funksionale dhe kërkesave konstruktive për lloje të tipologjive të posaçme të aktiviteteve kulturore.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kursit është të nxëni e njohurive të studentëve mbi bazën teorike konceptuale, aftësimin për pjesëmarrje në planifikim, programim, projektim arkitektonik të projekteve të integruara të ndërtesave të kulturës, në kontekst të dhe të bazuara në kushtet e mjedisit të trashëgimisë kulturore.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të kursit nga projektimi në kontekst kulturor në kuadër të specializimit të trashëgimisë studenti duhet të jetë i pregaditur që të: - Zbatoj strategji integruese të projektimit të objekteve të kulturës në kontekst me rrethinën e ndërtuar; - Përkufizoj stilin dhe qasjen në projektimin e ndërtesave të kulturës në përputhshmëri me kriteret në zonat e trashëgimisë kulturore; - Zbatoj metodat e projektimit të përshtatura për mjedisin se ku projektohet; - Integroj standardet e projektimit arkitektonik me kriteret e parashtruara të mjedisit të trashëgimisë kulturore;
Metodat e mësimdhënies:	Ligjerata, mënyra multimediale e prezentimit, komentimi analitik dhe krahasimi përmes të mjeteve të konkretizimit si projektori, llaptopi, tabela; ushtrimet e organizuara me punë në grupe (2 deri 3 studentë); vizita në teren, detyra individuale nën mbikëqyrje.
Metodat e vlerësimit:	Me dorëzimin dhe vlerësimin pozitiv të punimit individual/grupor, studenti fiton të drejtën e nënshkrimit. Kriteret e vlerësimit dhe kalueshmërisë në : Prezenca në ligjerata dhe aktiviteti në ushtrime (10%), eseu (15%), Kolokiumi (15%); projekti Individual/grupor (2-3 studentë) (55%); Provimi përfundimtar (5%)

Literatura primare:	<p>1. Ramsley, Sleeper, Architectural Graphic Standard (ninth edition), Wiley, AIA, New York, 1994</p> <p>2. Adler, D., METRIC HANDBOOK – Planning and Design Data (second edition), Architectural Press, OXFORD, 2000.</p> <p>3. Baiche, B. Walliman, N., Neufert-Architects' Data (third edition), Oxford, 2000.</p> <p>4. B.Daja&I.Sukaj, PROJEKTIMI ARK. I GOD. SOC –KULTURORE, Tiranë</p> <p>5. Thompson, Godfrey, Planing and Design of Library Buildings, Butterworth Architecture, 1989;</p> <p>6. Von Naredi-Rainer, Paul, Museum Buildings A design Manual, Birkhauser, 2004;</p> <p>7. Përmbledhje e ligjeratave, “Objektet e kulturës”, Prof.Ass.Dr. Vlora Navakazi</p>
Literatura shtesë:	<p>8. PHILIP JODIDO, ‘New Forms – Architecture in 1990’, Taschen</p> <p>9. CONTEMPORARY JAPANESE ARCHITECTURE, Taschen</p> <p>10. THE PHAIDON ATLAS OF CONTEMPORARY WORLD ARCHITECTURE</p>

Titulli i lëndës:	PLANIFIKIMI DHE TURIZMI KULTUROR
Mesimdhënesi:	Prof.Ass.Dr. Dukagjin Hasimja
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	<p>Turizmi është një industri në zhvillim me ndikime dhe potenciale të mëdha ekonomike, sociale dhe mjedisore. E përbashkët me shumicën e sektorëve të industrisë, një pjesë e madhe e ndikimeve të turizmit në mjedis konsiderohet si e dëmshme ose negative. Meqenëse një pjesë e madhe e industrisë i transporton dhe i joshë turistët në mënyrë specifike drejt zonave me vlera të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, planifikimi dhe mbrojtja e tyre shtron si nevojë adresimin e sfidave ekologjike dhe kulturore. Turizmi kulturor i planifikuar mirë mund të jetë katalizator për projekte të ruajtjes dhe konservimit. Studentët do të mësojnë se si të gjenerojnë dhe të hartojnë plane që analizojnë dhe rrisin turizmin kulturor në shkallë të ndryshme. Studentët do të informohen me shembuj lokal, rajonal dhe global të rasteve të ndryshme studimore ku turizmi kulturor ka kontribuar në mbrojtjen e zonave historike.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi i këtij kursi është të mundësojë studentët të analizojnë, dizajnojnë dhe planifikojnë procesin e zbatimit të turizmit kulturor në një sërë shkallësh. Kursi do të identifikojë dhe krahasojë ngjashmëritë, si dhe dallimet e turizmit kulturor në shkallë lokale, kombëtare, të gjeneruara në raport me politikën, fondet dhe mundësitë e bashkëpunimit rajonal.</p>
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> – thellojë kuptimin dhe të mundësinë e leximit dhe zhvillimit të planeve dhe politikave që trajtojnë turizmin kulturor

	<ul style="list-style-type: none"> – analizojë, vlerësojë dhe diagnostikojë çështjet që lidhen me turizmin kulturor, si dhe të punojë në idetë e planeve të qëndrueshme të turizmit kulturor – demonstrojë aftësitë e hulumtimit të aplikuar, të analizojë dhe zhvillojë aftësitë e të menduarit kritik
Metodat e mësimdhënies:	Ligjerata tematike, diskutime, punëtori me ligjërues të ftuar, vizita në terren, projekti i mbrojtjes preventive si detyrë semestrare.
Metodat e vlerësimit:	Pjesëmarrja e studentëve dhe angazhimi aktiv në klasë 10%, Detyrat dhe prezantimet e studentëve 70%, Vlerësimi nga testet 10% ose provimi përfundimtar 20%
Literatura primare:	R. C. Buckley (2010). Conservation Tourism, CAB International A. Orbasli (2000). Tourists in Historic Towns. Urban Conservation and Heritage Management, E & FN Spon R. Maitland, B.W.Ritchie, Eds. (2009). City Tourism. National Capital Perspectives, CAB International T.J Dallen J., Gyan P. Nyaupane. Eds. (2009). Cultural Heritage and Tourism in the Developing World, Routledge
Literatura shtesë:	P. Boniface, P. Fowler (1993). Heritage and Tourism. In The Global Village, Routledge P. Boniface (2003). Managing Quality Cultural Touris, Taylor & Francis G.J. Ashworth, P.J. Larkham (2013). Building a New Heritage. Tourism, Culture and Identity in the New Europe, Volume 3, Routledge W. J.V. Neill (2004). Urban Planning And Cultural Identity

Titulli i lëndës:	MBROJTJA PREVENTIVE
Mesimdhënesi:	Prof.Dr. Violeta Nushi
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	Lënda adreson qasjet themelore, parimet dhe praktikën e mbrojtjes preventive, si një nga angazhimet recente të institucioneve botërore të trashëgimisë kulturore (UNESCO, PRECOMOS) që kohëve të fundit është kthyer në fokus të mbrojtjes dhe qasjes institucionale në raport me veprimet dhe ndërhyrjet konservuese- restauruese të trashëgimisë arkitektuale. Lënda është konceptuar që të informojë studentët lidhur me sfidat e intervenimit shkencor dhe inventiv në ndërtesa historike nëpërmjet teknikave dhe materialeve të konservimit preventiv, me qëllim të kualifikimit, vlerësimit dhe zbatjes efektive të rrezeve dhe dëmeve strukturale në to. Studentët do të njihen me qasjen gjithëpërfshirëse dhe sistematike për ruajtjen parandaluese, arsyetimin e ruajtjes parandaluese në botë dhe në veçanti në Kosovë, praktikën e rekomanduar (skanarët e mirë dhe të këqij), agjentët e përkeqësimit, kontrollit dhe trajtimit, si dhe do të aftësohen në intervenim sipas shkallës së preventivës (primare, dytësore dhe tretësore) të konservimit.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i lëndës është që studentët të fitojnë njohuritë themelore në identifikimin e dëmeve dhe rrezeve të trashëgimisë së ndërtuar dhe të

	aftësohen në përcaktimin e shkallës së ndërhyrjes preventive. Gjithashu, që studentët të aftësohen në marrje vendimi të bazuar por edhe të shpejtë për mirëmbajtje, kontroll dhe monitorim, dhe konsolidim strukturor, varësisht nga shkalla e e identifikuar e rrezikshmërisë në ndërtesë.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none"> – zhvillojë ndjeshmërinë për aplikim të parimeve dhe shkallës së ndërhyrjes preventive në ndërtesë/lokalitet – krijojë qasje të bazuar në propozimet dhe masat konsoliduese dhe monitoruese varësisht nga qëllimi dhe valorizimi i ndërtesës/lokalitetit – zhvillojë sensin e intervenimit imediat në kushtet e përkeqësimit të shpejtë të trashëgimisë kulturore në situata risku apo emergjence
Metodat e mësimdhënies:	Ligjerata tematike, diskutime, punëtori me ligjërues të ftuar, vizita në terren, projekti i mbrojtjes preventive si detyrë semestrare.
Metodat e vlerësimit:	Vijueshmëria e studentit dhe angazhimi aktiv në klasë 10%, Detyrat semestrare dhe prezantimet e studentëve 50%, Vlerësimi nga testet 20% ose Provimi final 40%
Literatura primare:	HeritageCare (2017). General methodology for the preventive conservation of cultural heritage buildings, InterregSudoe Chris Caple (2000). Conservation Skills: Judgement, Method and Decision Making, Routledge K. V. Balen , A. Vandesande, Eds. (2013). Reflections on preventive conservation, maintenance and monitoring of Monuments and Sites, PRECOM ³ OS UNESCO chair, Acco Leuve/Den Haag
Literatura shtesë:	Michael Forsyth Ed. (2008). Materials & skills for historic building conservation, Blackwell Publishing Ltd P. Beckmann, R. Bowles (2004). Structural aspects of building conservation, Elsevier Butterworth-Heinemann Michael Forsyth (2007). Structures and Construction in Historic Building Conservation, Wiley-Blackwell C. A. Brebbia (2009). Structural Studies, Repairs and Maintenance of Heritage Architecture XI, WIT Press

Titulli i lëndës:	LABORATORI I DIZAJNIT KOMPJUTERIK
Mesimdhënesi:	Prof.Asoc.Dr. Arta Basha Jakupi
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	6
Përshkrimi i lëndës:	Kjo lëndë paraqet një qasje kompjuterike ose gjeneruese për të dizajnuar përdorimin e formave gramatikore. Forma gramatikore ishin një nga të parat dhe mbetet një nga sistemet e pakta të dizajnit kompjuterik që janë tërësisht vizuale, sesa tekstuale apo numerike. Ato sigurojnë një mjet të fuqishëm për analiza dhe sintezë të dizajnit, për eksplorimin e dizajnit dhe për gjenerimin e zgjidhjeve të dizajnit të ri.

	Bazat e formave gramatikore do të futen përmes leksioneve dhe përmes ushtrimeve në klasë. Një gamë e aplikacioneve nga analiza stilistike deri tek dizajni kreativ do të hulumtohet. Do të paraqiten programe kompjuterike për format gramatikore.
Qëllimet e lëndës:	Përtej aplikimit të teknikave dhe mjeteve digjitale, përpjekjet e projektimit kompjuterik punojnë për të rishikuar marrëdhënien midis përshkrimit formal, ndërtimit sistematik, analizës së performancës dhe prodhimit industrial. Dizajni kompjuterik hulumtohet si një mjet për identifikimin dhe kodimin e këtyre dimensioneve diskrete të dizajnit në një projekt sintetik të projektimit, inxhinierisë, fabrikimit dhe banimit.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> - njohuri dhe ekspertizë në dizajnin kompjuterik dhe fabrikimin digjital në lidhje me projektimin e ndërtesave dhe arkitekturës në përgjithësi. Kurset mbulojnë programimin për dizajnin kompjuterik dhe fabrikimin digjital duke përdorur mjetet CNC të prerjes (printerat 3D, kuti laserike etj.) - zhvillimi i mendimit kritik për metodologjitë specifike të projektimit, aplikimet aktuale dhe përparimet në zhvillim në fushën e dizajnit kompjuterik dhe fabrikimit digjital. - njohja dhe identifikimi i efektit të këtyre metodologjive dhe aplikimeve në prodhimin e mjedisit të ndërtuar. - Tregoni origjinalitet në aplikimin e analizave dhe njohurive kërkimore në fushën e dizajnit kompjuterik dhe fabrikimit digjital përmes projekteve të projektimit.
Metodat e mësimdhënies:	Klasat do të kombinojnë leksione interaktive, tutoriale, diskutim, punë praktike, analizë të rasteve studimore, punë seminare dhe punë studimore. Çdo klasë ka një sërë leximi, dhe është e rëndësishme që studentët të vazhdojnë me leximet dhe të jenë të përgatitur për t'i diskutuar ato në klasë. Hulumtimi zhvillohet në grupe tematike, ndërsa projekti është individual ose në grupe.
Metodat e vlerësimit:	Prezenca e studentit 5%; Vlerësimi i Parë 35%; Vlerësimi i dytë 35%; Puna individuale 25%, provimi përfundimtar për ata që nuk kanë kaluar vlerësimin e parë dhe të dytë.
Literatura primare:	T. W. Knight, (1994) Transformations in Design (Cambridge University Press, Cambridge)
Literatura shtesë:	Menges A. & Ahlquist S., (2011) Computational Design Thinking: Computation Design Thinking, Wiley Leach N. & Yuan F.P., (2018) Computational Design, Tongji University Press Co Wassim J., (2013) Parametric Design for Architecture, Laurence King Publishing

Titulli i lëndës:	PROJEKTIMI NDËRDISCIPLINAR
Mesimdhënesi:	Prof.Ass.Dr. Arta Xhambazi
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	6

Përshkrimi i lëndës:	Edhe pse arkitektura në natyrën e saj është interdisciplinare, bashkëpunimi ndërdisiplinar kërkon të kuptuarit e qartë të njohurive vetanake, të kuptuarit dhe respektimin e njohurive që vijnë nga disiplina tjera relevante dhe aftësinë për t'i komunikuar këto njohuri. Arkitektët dhe inxhinieret pretendojnë që janë dizajnerë, edhe pse mënyra se si ata e definojnë dizajnin apo projektimin ndryshon shumë. Megjithatë, interaksioni mes të dyja palëve ka gjeneruar objekte më mbresëlënëse të botës. Lënda trajton mardhënien midis strukturës dhe projektimit, projektimin sistematik, kontekstual si dhe dizajni kompjutacional. Në të gjitha rastet teknologjia digjitale nuk bën vetëm të qartë kompleksitetin dhe jo-linearitetin e procesit të projektimit, por rrit edhe mundësinë për vizualizim, reprezentim si dhe analizë të sjelljeve strukturore, duke ndryshuar arkitekturën, inxhinierinë por edhe mundësinë për ndërveprimin e tyre.
Qëllimet e lëndës:	Lënda mëton të krijojë hapësirë në të cilën stimulohet diskursi, vihen në pyetje konceptet e para-vendosura arkitektonike, dhe kërkohen strategji të reja duke zgjëruar fushën e hulumtimit në arkitekturë në raport me disiplinën dhe praktikën.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të kursit, studenti: <ul style="list-style-type: none"> – demonstroi njohuri për procesin e projektimit – diferencoi qasjet dhe zbatoi metoda hulumtuese dhe krijuese nga disiplina tjera për të kryer hulumtime dhe për të zhvilluar strategji projektimi – shpjegon dhe reflekton mbi marrëdhëniet ndërmjet analizave, konceptimit, metodave dhe përbërjes së një propozimi për projekt. – pozicionon projektin brenda një kuadri të veçantë teorik, historik, social ose kontekstual. – diskuton kuptim koherent, korrekt dhe domethënës të projektit.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjerata, puna në terren, analiza të rasteve studimore, punë seminarike dhe punë studio. Hulumtimi zhvillohet në grupe tematike, ndërsa projekti është individual ose në grupe.
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimet bazohen në performancën e përgjithshme brenda studios e cila përcaktohet nga cilësia e punës, përkushtimit, punës ekipore, përpjekjeve dhe zhvillimeve gjatë tërë semestrit. Aspektet konkrete për vlerësim janë: puna kërkimore, formulimi i argumenteve, shndërimi i argumentit në koncept, projekti arkitektonik, prezantimi.
Literatura primare:	Kara, H. And Georgoulas, A. (Eds). (2013). Interdisciplinary Design: New Lessons from Architecture and Engineering. Harvard University Graduate School of Design Moussavi, F. (2009). The Function of Form. Barcelona Spain and Cambridge, Massachusetts: ACTAR and Harvard University Graduate School of Design. Moussavi, F.& Kubo, M. (2008). The Function of Ornament. ACTAR and Harvard University Graduate School of Design Kronenburg, R. (2001). Spirit of the Machine: Technology as an Inspiration in Architectural Design. Chichester, West Sussex: Wiley Academy
Literatura shpesh:	Geiser, R. (Ed.). (2008). Explorations in Architecture: Teaching Design Research. Birkhäuser: Basel, Boston, Berlin.

	A. Gleiniger, & G. Vrachliotis (Eds.). (2009). Pattern: Ornament, Structure and Behavior. Basel,Boston&Berlin: Birkhäuser. Lance La Vine. (2001). Mechanics and Meaning in Architecture. Minneapolis & London:University of Minnesota Press
--	--

Titulli i lëndës:	ZHVILLIMI I DIZAJNIT PARAMETRIK NE ARKITEKTURE
Mesimdhësi:	Prof.Ass.Dr. Teuta Jashari Kajtazi
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	6
Përshkrimi i lëndës:	Dizajni parametrik nuk ka qene asnjehere i panjohur per arkitektet. Qe prej koherave te lashta me piramidat antike e deri tek paraqitjet bashkekohore, objektet jane projektuar dhe ndertuar ne raport me nje numer te caktuar forcash, perfshire klimen, teknologjine, shfrytezimin, karakterin, vendndodhjen, kulturen, disponimin. Ne kete kontekst, mund te thuhet se kompjuteri nuk e ka zbuluar dizajnin parametrik dhe as qe e ka ridefinuar rrugetimin e arkitektures, por ka mundesuar qe arkitektet te projektojne struktura me inovative me kushte me kualitative.
Qëllimet e lëndës:	Njohja me rrugetimin e dizajnit parametrik qe prej koherave kur shperthimi ne kete drejtim ka qene i perdorshem per arkitektet, dhe ate me momentumin e avancimeve ne bio-shkence ne vitet e 80ta te Shekullit 20 si dhe morfologjise shtazore, te cilat mbeshteten inovacionet ne aplikimin e parametrikes edhe ne strukturat tektonike.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Te kuptuarit e zhvillimit dhe interpretimit historik te dizajnit parametrik Te kuptuarit e ndikimit te disiplinave tjera ne formesimin e arkitektures parametrike Njohja me Arkitektet baze si dhe ata te bashkekohores, te cilet aplikojne dizajnin parametrik ne proces te projektimit
Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata/ Leksione teorike dhe praktike Obligimet semestrare te studenteve jane si ne vijim: - Pune grupe (tre pjesemarres me se shumti) - Detyra semestrare perfshine hulumtim, casje teorike dhe realizim te ideve dhe koncepteve parametrike ne kontekst.
Metodat e vlerësimit:	Detyra semestrare me prezentime_50% Testet semestrare (2x20%)_40% Vijimi i rregullt dhe aktiviteti_10% Totali_100%
Literatura primare:	Archeology of the Digital; <i>Greg Lynn</i> , 2013 The Digital Turn in Architecture 1992 – 2012; <i>Mario Carpo</i> , 2013 <i>Teuta Jashari-Kajtazi</i> , Ligjeratat dhe Prezentimet, te cilat do te shperndahen pas cdo njesie te ligjeruar
Literatura shpërndarë:	Parametricism 2.0: Rethinking Architecture's Agenda for the 21st Century, 2016 Digital Hadid; <i>Patrik Schumacher</i> , 2004 Total Fluidity: Studio Zaha Hadid, Projects 2000 - 2010 University of Applied Arts, Vienna, 2011

Titulli i lëndës:	ARKITEKTURA E QËNDRUESHME DHE SOTFUERËT
Mesimdhënesi:	Prof.Dr. Violeta Nushi
Statusi i lëndës:	Obligative
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	Kursi Arkitektura e Qëndrueshme dhe softuerët diskuton dhe studion fushën e arkitekturës që kërkon të minimizojë ndikimin negativ mjedisor të ndërtesës me efikasitet dhe modelim në përdorimin e materialeve, hapësirës për energji dhe zhvillim dhe ekosistemit në përgjithësi duke përdorur softuerët. Lënda paraqet bazat e arkitekturës dhe ndërtimit të qëndrueshëm, nëpërmjet të dhënave të studimeve të rasteve dhe përkufizimet për: zhvillimin e arkitekturës së qëndrueshme, analizën e ndikimit mjedisor në arkitekturën dhe ndërtimin duke përdorur softuerë.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimet e kursit (modulit): Të ofrojë studentëve një pasqyrë të fushës së gjerë të arkitekturës dhe ndërtimit të qëndrueshëm; për të analizuar ndikimin mjedisor të arkitekturës dhe zhvillimeve të ndërtimit në mjedisin e ndërtuar; për të nxjerrë në pah aspekte të ndryshme të qëndrueshmërisë dhe t'i integrojë ato drejt arkitekturës dhe ndërtimit të qëndrueshëm duke përdorur softuerë që u mundëson projektuesve të përcaktoj sasinë e ndikimeve mjedisore të sistemeve dhe materialeve për të mbështetur vendimet e nevojshme për të dizajnuar ndërtesa të qëndrueshme.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi, studentët duhet të jenë në gjendje që në fushën e arkitekturës dhe ndërtimeve të qëndrueshme të dijnë: psh. Të aplikojnë EcoDesigner STAR, i ndërtuar për të shërbyer me dizajn shumë të efektshëm të energjisë duke kthyer Modelet e Informacionit të Ndërtimit të ARCHICAD (BIM) në Modele të Ngrohtësisë së Ndërtimit (BEM) të shumëfishta termike, ose softuer të përcaktuar për tu përdorur përgjatë vitit akademik.
Metodat e mësimdhënies:	Metodat e mësimdhënies do të përfshijnë ligjerata, seminare, punë të pavarur në klasë, dhe detyra shtëpie individuale. Lënda do të përfshijë aktivitete teorike dhe praktike dhe do të jetë kryesisht interaktive, duke angazhuar në diskutim të gjithë studentët, eventualisht akademinë dhe pjesëmarrësit e komunitetit. Për ligjërata dhe ushtrimet përdoren teknika dhe mjete të ndryshme vizuale dhe softuerike.
Metodat e vlerësimit:	Metodat e vlerësimit dhe kriteret e përshtatshmërisë për kursin: <ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja e nxënësve dhe vlerësimi i aktivitetit 15% - Vlerësimi ndërmjetës 15% - Portfolio e veprës grafike, të vlerësuar me notë pozitive - gjatë semestrit, si kusht për të fituar të drejtën për provim, 40% - Provimi përfundimtar, provimi me shkrim 30%
Literatura primare:	<ul style="list-style-type: none"> - Leksione të përgatitura nga Prof. Dr. V. Nushi - Kibert, Ch. J., “Sustainable Construction: Green Building Designs and Delivery, 2007
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> - McLennan, J. F., “The Philosophy of Sustainable Design”, 2004

	<ul style="list-style-type: none"> - Williamson, T., Radford, A., Bennetts, H., ‘Understanding Sustainable Architecture’, 2003 - Williams, D.E.; Orr, D.W., “Sustainable Design: Ecology, Architecture and Planning”, 2007
--	--

Titulli I lëndës:	SOFTUERËT DHE WEB-APLIKACIONET
Mesimdhësi:	Prof.Dr. Blerim Rexha
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Kredite ECTS:	4

Përshkrimi I lëndës:	<p>Ndërtimi i modelimit të informacionit (BIM) është një proces që përfshinë gjenerimin dhe menaxhimin e informacionit rreth një objekti. BIM lejon një integrim të madh dhe bashkëpunim midis profesionistëve të ndryshëm ndërtimi të disiplinave të ndryshme për të eksploruar në mënyrë digjitale dhe mund të përdoren gjatë tërë procesit të ndërtimit nga faza e projektimit deri në fazën e ndërtimit dhe madje edhe pas ndërtimit të menaxhimit të ndërtimeve. Studentët do të mësojnë se si BIM është i dobishëm në mbështetjen e vendimmarrjes së investimeve në lidhje me punët e kapitalit dhe infrastrukturën;</p> <p>si BIM mund të ndihmojë në krahasimin e zgjidhjeve alternative për projektimin, shërbimet energjetike dhe mjedisore dhe ndërtimin e metodës; si BIM mund të ndihmojë me vizualizimin e dizajnit për klientin; se si BIM mund të ndihmojë në identifikimin e çështjeve të ndërtimit dhe përplasjeve duke përfshirë sigurimin e cilësisë dhe sigurinë; dhe si mund të përdoren të dhënat e BIM për të menaxhuar objektin e përfunduar deri në fund të jetës së saj të dobishme. Njësia përfshin mësimin nga studimet e rasteve.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Ky kurs do t'u japë studentëve një kuptim të përgjithshëm të koncepteve të Modelimit të Informacionit të Ndërtimit (BIM) gjatë tërë ciklit të jetës së një ndërtese, nga planifikimi, dizajni, ndërtimi dhe operacionet. Ne do të përqendrohemi në fushat teknike dhe profesionale të inxhinierisë.</p> <p>Duke marrë këtë klasë, ata do të jeni në gjendje të:</p> <ol style="list-style-type: none"> (1) Përcaktojnë BIM; (2) Përshkruajnë rrjedhën e punës në përdorimin e BIM në ciklin e ndërtimit; (3) Kryejnë vlerësimin e kostos së modelit; (4) Kryejnë simulime 4D; (5) Aplikojnë BIM për të zvogëluar gabimet dhe për të ndryshuar porositë në projektet kapitale; (6) Vlerësojnë dhe komunikojnë idetë e tyre lidhur me përdorimin e BIM në ciklin e jetës së ndërtesës.
Rezultatet e nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - demonstrojnë njohuri për proceset dhe përfitimet e BIM-it; - pajisjen e studentëve me modelin praktik 3D BIM Arkitektural; - demonstrojnë shkathtësi dhe njohuri teknike për të filluar dhe mbështetur një projekt duke përdorur BIM; - krahasojnë dhe dallojnë njohuritë e komponenteve të ndryshme arkitekturore dhe teknologjike

	<p>- Zhvillimi i fjalorit të ndërtimit dhe të infrastrukturës për të qenë në gjendje të përshkruajë një ndërtesë, përbërësit e tij dhe sistemet e saj, duke përfshirë komponentët e arkitekturës, MEP (mekanike, elektrike, hidraulike) dhe strukturore.</p> <p>- përshkruajnë evolucionin dhe zhvillimin e BIM-it, deri në ditët e sotme.</p> <p>- Të krahasojnë, duke përfshirë avantazhet dhe disavantazhet e BIM vs. 2D dhe 3D CAD - shpjegojnë sfidat dhe pengesat që ende ballafaqohen me përdorimin e BIM.</p>
Metodat e të mësuarit:	Ligjërata, punë në terren, analiza e studimit të rasteve, punë seminarike dhe punë studimore. Hulumtimi zhvillohet në grupe tematike, ndërsa projekti është individual ose në grupe.
Metodologjia e vlerësimit:	Ky është një kurs i zgjeruar në internet i cili do të ofrojë detyra të problemeve, zgjidhje dhe eksperimente laboratorike, teknika dhe zgjidhje.
Literatura Primare:	Eastman Ch., et al(2011) BIM Handbook: A Guide to Building Information Modeling for Owners, Managers, Designers, Engineers and Contractors, Wiley
Literatura Shtesë:	Kensek, Karen and Noble, Douglas (2014). Building Information Modeling: BIM in Current and Future Practice, Wiley. Cranbourne Ch., et al (2016) Implementing Virtual Design and Construction using BIM: Current and future practices, Routledge Kensek M. K., (2014) Building Information Modeling, Routledge

Titulli i lëndës:	QYTETET E ZGJUARA
Mesimdhënesi:	Prof.Ass.Dr. Dukagjin Hasimja
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	Kursi do t'ju ofrojë një kuptim të elementeve themelore të një qyteti të zgjuar dhe do të adresojë gjerësinë e sistemeve që e përbëjnë atë: infrastrukturën e ndërtuar, energjinë, ujin, transportin, prodhimin / shpërndarjen e ushqimit dhe shërbimet publike / sociale. Theksi i barabartë do të vendoset në adresimin e anës së kërkesës së ekuacionit - që do të thotë jo vetëm që sistemet të jenë më efikase dhe efektive, por edhe të ndikojnë në sjelljen e konsumit. Studimet e rasteve do të përdoren për të ilustruar qasjet, përfitimet dhe rreziqet e përfshira.
Qëllimet e lëndës:	Një qytet i zgjuar është ai ku nevojat e një populli përmbushin nevojat e qëndrueshmërisë mjedisore. Bilanci midis çështjeve sociale dhe mjedisore udhëhiqet nga Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) që fuqizon një infrastrukturë të zgjuar të qytetit. Në këtë kurs do mësojmë për ndikimin e rrjeteve urbane, planifikimin e zgjuar urban të qytetit, energjinë si një katalizator i zhvillimit të qëndrueshëm, infrastrukturës së zgjuar të qytetit, transportit të qëndrueshëm, rrjedhjes së informacionit dhe komunikimit, rrjeteve të zgjuara, infrastrukturës digjitale dhe rolin e të dhënave dhe teknologjia e informacionit. Ne do të diskutojmë kriteret për matjen e zgjuarsisë së një qyteti, duke përfshirë cilësinë e jetës, qeverisjen e qytetarëve, dhe diskutojmë çështjet që shkojnë drejt krijimit të një qyteti të zgjuar në të

	ardhmen. Disa studime rastesh do të prezantohen me ligjëruesit e ftuar për të paraqitur të menduarit kritik dhe praktikat në zhvillimin e zgjuar të qytetit.
Rezultatet e nxënies:	Deri në fund të kursit, studentët pritet të: - Eksplorojnë dhe kuptojnë konceptet dhe debatet aktuale rreth qyteteve të zgjuara, të qëndrueshme dhe të ardhshme, - Shpjegojnë dhe të jeni të vetëdijshëm për rëndësinë e lidershit dhe qeverisjes në krijimin e qyteteve të zgjuara dhe rolin e aktorëve të ndryshëm përfshirë qeverinë, autoritetet lokale, biznesin, universitetet dhe komunitetet, - Të aplikojnë dhe të konsiderojnë lidhjet ndërmjet inovacionit urban, ndërmarrjes dhe modeleve të ardhshme të biznesit të zgjuar të qytetit, - Identifikimi dhe njohja e rolit dhe rëndësisë që TIK, të dhënat dhe analitika urbane mund të luajnë në adresimin e sfidave kyçe urbane dhe çështjeve kyçe në lidhje me këtë, - Eksplorojnë qasje të ndryshme për përfshirjen e qytetarëve në qytetet e zgjuara dhe planifikimin për qytetet e ardhshme.
Metodat e të mësuarit:	Ligjërata, puna në terren, analiza e studimit të rasteve, detyrat seminarike dhe puna studimore. Hulumtimi zhvillohet në grupe tematike, ndërsa projekti është individual ose në grupe.
Metodologjia e vlerësimit:	Vlerësimi do të bazohet në performancën gjatë gjithë semestrit, duke përfshirë pjesëmarrjen në klasë, skicat, për të dhënë konkluzione mbi kapacitetin e llojeve të ndryshme të projekteve të zgjuara të qytetit për të adresuar sfidat urbane në rajon dhe gjithashtu për të shërbyer si një kornizë të strukturuar për të caktuar vlerat e vlerësimit për projektet dhe prioritetet e sfidave për qytete të ndryshme.
Literatura Primare:	Townsend M. A., (2013) Smart Cities: Big Data, Civic Hackers, and the Quest for a New Utopia
Literatura Shtesë:	Herzberg C., (2017) Smart Cities, Digital Nations: Building Smart Cities in Emerging Countries and Beyond, Roundtree Press Coletta C., Evans L., Heaphy L., Kitchin R., (2018) Creating Smart Cities, Taylor & Francis Barlow M., Levy-Bencheton C., (2018) Smart Cities, Smart Future, Wiley.

Titulli i lëndës:	PROJEKTIMI KINETIK INTERAKTIV
Mesimdhënesi:	Dr.sc. Miranda Rashani
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	Kursi 5 AT: Projektimi Kinetik Interaktiv diskuton dhe studion temën e ndërtesave me sisteme interaktive, të cilat ofrojnë komoditet më të madh, efikasitet energjetik, fleksibilitet urban dhe ‘zgjuarsi’. Projektimi Kinetik për Arkitekturë Interaktive është në gjendje të ofrojë një dimension të ri të projektimit arkitektonik, duke ndryshuar dhe duke u mundësuar banorëve një stil të ri të jetës, interaktivitet me shumë pajisje, siguri të shtuar, dhe një cilësi të përmirësuar të jetës për të gjithë. Kursi zhvillohet një herë në javë dhe është kurs i integruar me pjesëmarrje interaktive të studentëve. Tipologjia e Projektimit Kinetik për Arkitekturë Interaktive do të caktohet për çdo vit

	akademik sipas trendeve aktuale në bashkëpunim me studentët dhe referencat ndërkombëtare akademike.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kursit është të iniciojë, të përdorë parimet e avancuara teorike dhe praktike të Projektimit Kinetik për Arkitekturë Interaktive, duke përfshirë ndërlidhjen simbiotike të avancimit të teknologjisë ‘smart city’, dhe eres së re të zhvillimit urban. Objektivat kryesore të kursit janë subjekt i qasjeve të ndryshme ndërdisiplinore për të zgjidhur problemet e zhvillimit urban, duke zgjidhur varietetet e problemeve në teknologjinë arkitektonike.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të kursit, studentët duhet të kenë kuptuar dhe zotëruar parimet e avancuara të Projektimit Kinetik për Arkitekturë Interaktive: <ul style="list-style-type: none"> - Studentët kanë zhvilluar aftësitë dhe teknikat në Projektimin Kinetik - Studentët kanë zhvilluar aftësitë e nevojshme për projektim e komplekseve urbane, me Projektim Kinetik për Arkitekturë Interaktive ; - Studentët kanë zhvilluar aftësi dhe teknika për të përshkruar, analizuar dhe artikuluar procesin e projektimit kinetik.
Rëndësia dhe Aktualiteti i Lëndës	Kursi 5T: Projektimi Kinetik Interaktiv, promovon dhe inicon kuptuarjen e njohurive të avancuara të projektimit interaktiv. Tematika e shtjelluar në kurs korespondon, dhe aktualisht është në vijë me trendet bashkëkohore të mësimdhënjes në universitetet europiane dhe më gjërë. Për më shumë, studentët janë të pajisur me literaturën primare në gjuhën Shqipe falas, nga mësimdhënësi i kursit.
Metodat e mësimdhënies:	Mësimdhënia ka karakterin e diskutimeve interaktive, duke angazhuar në diskutim të gjithë studentët. Gjithashtu, kursi synon që studentët të marrë pjesë në punë në grup, dhe individuale, të cilët do të marrin detyra konkrete në formën e projekteve ideore arkitektonike. Ligjëratat, dhe ushtrimet gjatë mësimin në klasë përdorin mjete dhe teknika të ndryshme vizuale, kurse gjatë punës me studentë në konsultimet individuale promovohet dhe vlerësohet puna e pavarur në klasë, si dhe angazhimi dhe detyrat e shtëpisë.
Metodat e vlerësimit:	Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë për kursin: <ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja e studentit në ligjerata dhe ushtrime, aktiviteti 20% - Vlerësimi obligativ intermediar - Fazat 30% - Portfolio e punimeve grafike, detyrave, seminareve, të vlerësuar me notë - pozitive gjatë semestrit, janë kusht për të marrur ECTS – si dhe janë kusht - për t’iu nënshtruar provimit përfundimtar 30% - Provimi përfundimtar, Test me shkrim. 20%
Literatura primare:	14. Bujar Bajçinovci, Sustainable Architectural Design – principles, in the Albanian Language, 4 (3), JOSHA, 2017. DOI: 10.17160/josha.4.3.306 15. Bujar Bajçinovci, Interactive Kinetic Architecture: Progressive Design Principles, 6 (2), JOSHA, 2019. DOI: 10.17160/josha.6.2.535

	16. Bujar Bajçinovci, Biomimicry and Biophilic Design: Multiple Architectural Precepts, 6 (3), JOSHA, 2019. DOI: 10.17160/josha.6.3.544
Literatura shtesë:	7. Batty, M., Torrens M.P. (2005). Modelling and prediction in a complex world. London, UK. Salt Lake City, USA: Elsevier.

Titulli i lëndës:	INTERPOLIMI NE ARKITEKTURE
Mesimdhënesi:	Prof.Ass.Dr. Teuta Jashari Kajtazi
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	Interpolimi si nje nga metodat e intervenimit ne strukturat apo hapësirat urbane ekzistuese, mundeson rijetesimin bashkekohor te nje objekti, funksioni apo hapësire. Ne kete kontekst, nderhyrja me trajta, materializime dhe funksione te kohes, qofte minimaliste apo edhe me aplikim te elementeve te dizanit parametrik, eshte nje nga menytrat me te kerkuara bashkekohore.
Qëllimet e lëndës:	Dhenia e mundesive te ndryshme te nderhyrjes ne kontekst ekzistues arkitekturor, urban apo edhe ne enterier, eshte nje nga qellimet kryesore te lëndës. E tera nepermes dhenies se shembujve konkret dhe te vecant te nderhyrjes ne njeren dhe respektimit te kontekstit ekzistues ne anen tjetër.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Arritja deri te respektimi i kontekstit ekzistues. Nderhyrja ne masen e kerkuar, si ne forme ashtu edhe ne funksion, marr parasysh kerkesat e kohes. Respektimi i vlerave te objektit dhe kontekstit urban ekzistues, si dhe rritja e po te njejtave vlere ne raport me kohën. Perafrimi me parametrikën si nje nder trajtat bashkekohore te interpolimit. Menytrat se si e vjetra duhet te perfshihet ne projektimin e te ardhmes.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata/ Leksione teorike dhe praktike Obligimet semestrare te studenteve jane si ne vijim: - Pune grupore (tre pjesemarres me se shumti) - Detyra semestrare perfshine hulumtim, casje teorike dhe realizim te ideve dhe koncepteve te interpolimit parametrik ne kontekst ekzistues.
Metodat e vlerësimit:	Detyra semestrare me prezentime_50% Testet semestrare (2x20%)_40% Vijimi i rregullt dhe aktiviteti_10% Totali_100%
Literatura primare:	Adaptive Reuse: Extending the Lives of Buildings; <i>Liliane Wong</i> , 2017 Integrating innovation in architecture; design, methods and thechnology for progressive practice and research; <i>Ajla Aksamija</i> , 2017 <i>Teuta Jashari-Kajtazi</i> , Ligjeratat dhe Prezentimet, te cilat do te shperndahen pas cdo njesie te ligjeruar
Literatura shtesë:	Transformer: Reuse, Renewal, and Renovation in Contemporary Architecture; <i>Sandu publishing</i> , 2010 Adaptive Architecture: Changing Parameters and Practice; <i>Wolfgang F. E. Preiser, Andrea E. Hardy, Jacob J. Wilhelm</i> , 2017

Titulli i lëndës:	HAPËSIRA DHE JETA E PËRDITSHME
Mesimdhënesi:	Prof.Asoc.Dr. Vjollca Krasniqi
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Kredite ECTS:	4
Përshkrimi i lëndës:	Lënda ofron një shqyrtim të teorive dhe koncepteve mbi hapësirën dhe jetën e përditshme për të kuptuar ndërveprimin shoqëror dhe kulturor në kohë dhe përgjatë hartës sociale. Lënda sjell në vëmendje proceset e strukturimit shoqëror, shprehjet që marrin në jetën e përditshme: rregullave formale dhe praktikave jo-formale, temporalitetin dhe (ri)prodhimin e hapësirës në/përmes aspekteve të zakonshme të jetës bashkëkohore.
Qëllimet e lëndës:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Qëllimi i lëndës është të analizojmë ndërveprimin shoqëror në hapësirën publike, personale dhe jetën e përditshme; 2. Kuptimi i teorive micro sociologjike dhe zhvillimi i imagjinatës sociologjike; 3. Kuptimi i aspekteve të jetës së përditshme, dhe 4. Zhvillimi i mendimit kritik, analitik dhe kreativ.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> • Studentët në përfundim të lëndës do të mund të: • Analizojnë sjelljen njerëzore në jetën e përditshme dhe ndikimin e hapësirës; • Të nxisë reflektimin e studentëve për të zgjidhur problemet e hapësirës përmes të kuptuarit të situatave të ndryshme në jetën e përditshme; dhe • Të aplikojnë teori mikro sociologjike në studimin e hapësirës.
Metodat e mësimdhënies:	Metodologjia e mësimdhënies është e bazuar në ligjërata, ushtrime dhe punë praktike. Çdo student ka për obligim që të përgatisë dy detyra të shtëpisë. Mësimdhënësja shpjegon objektivat e mësimin studentëve përmes ligjëratave, përmes tabelës, projektorit dhe formave tjera vizuale prezantohen teoritë dhe konceptet kryesore. Mësimi i kombinuar interaktiv do të përdoret. Poashtu në lëndë do të zhvillohen diskutime and prezantime grupore nga studentët.
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i pare; Vlerësimi i dytë; Vlerësimi i ushtrimeve; Vlerësimi i maketave; Vijimi i rregullt; Provimi final; Total (përqindja mesatare) 100%.
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Bennett, Tony dhe Watson, Diane. 2002. Understanding Everyday Life. U.K.: Blackwell. 2. Certeau, Michel de. 2002 (1984). General Introduction to The Practice of Everyday Life, në The Everyday Life Reader. Ben Highmore (ed.) London. New York: Routledge. 3. Goffman, Erving. 1990. The Presentation of Self in Everyday Life. London: Penguin. 4. Jameson, Frederic. 1997. Is Space Political? Rethinking Architecture: A Reader in Cultural theory, Neil Leach (ed.) London, New York: Routledge. 5. Lefebvre, Henri. 2002. (1991). Work and Leisure in Everyday Life, në The Everyday Life Reader, Ben Highmore (ed.) London, New York: Routledge.

Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none">1.Dreyfus, Hurbert dhe Rabinow Paul. 1984. Michel Foucault: Beyond Structuralism and Hermeneutics. Brighton: The Harvester Press.2.Lefebvre, Henri. 1991. The Production of Space. Oxford, Cambridge: Blackwell.3.Steenberg, Rune. 2016. The Art of Not Seeing like a State. On the Ideology of 'Informality, Journal of Contemporary Central and Eastern Europe, 24(3): 293–306.
-------------------------------	---